



Naša uprava

institut alternativa

CIN Centar za
istraživačko
novinarstvo
Crne Gore

NH
NEW HORIZON
Civil Society Organization

Natura
NVO Natura-Kolašin



Reforma e administratës publike: Sa larg është viti 2020?

Pasqyrimi i situatës për vitin 2016
dhe gjysmën e parë të vitit 2017.



Ky projekt financohet nga
Bashkimi Evropian

Titulli i publikimit:

Reforma e Administratës Publike: Sa larg është viti 2020?

Botues: **Instituti Alternativa**

Bulevardi Xhorxh Vashington 57, Podgoricë, Mali i Zi

Tel/fax: **+ 382 (0) 20 268 686**

E-mail: **info@institut-alternativa.org**

Për botuesin: **mr Stevo Muk**

Redaktor: **mr Stevo Muk**

Autore: **mr Milena Milošević**

Hulumtuesë: **Ana Đurnić, Aleksandra Vaviq, Ivana Bogojeviq, Jovana Bulatoviq**

Bashkëpunëtorë në hulumtim: **Amra Strujiq, Milan Medenica, Nazif Veliq**

Përkthyes: **Ibrahim Berjashi**

Faqosja dhe dizajni: **Ana Jovoviq**

Shtypi: **Shtypshkronja “Lapis”**

Podgoricë, qershor 2017.

Каталогизација у публикацији
Национална библиотека Црне Горе, Цетиње

ISBN 978-9940-533-60-1
COBISS.CG-ID 33998608



Kjo broshurë u krijua në kuadër të projektit ‘SHOQËRIA CIVILE PËR QEVERISJE TË MIRË: SHËRBIM DHE MERITË’, që financohet nga Bashkimi Evropian dhe implementohet nga Instituti Alternativa, Bonum, Natura, Horizonti i Ri dhe Qendra për Gazetari Hulumtuese. Përmbajtja e kësaj broshure është përgjegjësi vetëm e autorit dhe në asnjë mënyrë nuk paraqet qëndrimet e Bashkimit Evropian.

PËRMBLEDHJE

Lënda e këtij raporti është kundrimi i gjendjes në fushat kryesore të reformës së administratës publike, së bashku me pasqyrën e përgjithshme të zbatimit të Strategjisë mbi reformat e administratës publike 2016-2020.

Fillimi i implementimit të Strategjisë ende nuk i ka dhënë hov reformës së administratës publike: gjatë 11 muajve të parë të aplikimit, 60 % të aktiviteteve nuk janë realizuar në afatin e caktuar. Konstatimet e raportit tregojnë se zhvillimet dhe koordinimi i politikave publike dhe menaxhimi me resurset njerëzore, janë në veçanti lëndë problematike.

Gjatë gjysmës së parë të vitit 2017 plotësisht janë shmangur shqyrtimet publike mbi ndryshimet e rëndësishme ligjore, të cilat ndër të tjera, rregullojnë çështjet publike të prokurimit dhe qasjes së lirë të informacioneve.

Ndryshimet e Ligjit mbi Qasjen e Lirë në Informata, edhe pse formalisht është njëra nga veprimtaritë e parapara me Strategji, shënon një hap pas në transparencën e punës së administratës. Ato paraqesin shtesë kufizimit të qasjes së informacionit, siç janë fshehtësitë e punës dhe tatimit edhe argumentimit të interesit të posaçëm.

Punësimi në nivelin lokal, sidomos, është rregulluar keq, i cili shfaqet në lëshimet, siç janë shpallja e vendeve të punës të cilat tashmë janë të plotësuara edhe mungesa e konfirmimit të aftësive.

Diskrecion tepër i madh i autorizimeve lidhur me punësimin në nivelin shtetëror, po ashtu, ka ndikim negativ në krijimin e sistemit të merituar në administratën tonë. Këta probleme shihen edhe në perceptimin negativ të qytetarëve kur kemi të bëjmë me këtë fushë. Problemi më i theksuar të qytetarët, pikërisht është "punësimi nëpërmjet lidhjeve".

Qytetarët, shërbimet publike i vlerësojnë me një notë mesatare, ndërsa përvojën e "vizituesve sekretë", të institucioneve të zgjedhura në territorin e tetë komunave, tregojnë relativisht një përmbushje më të madhe të standardit të cilësisë së shërbimeve.

"Përgatitja e terrenit" të ligjit të ri, Ligji mbi Procedurën Administrative (LPA) dhe nis aplikimin që më 1 korrik 2017, nga i cili pritet avancimi i dhënies së shërbimeve, ka hasur në vështirësi, të cilat shfaqen në lëmin e mosharmonizimit të ligjeve të veçanta me dispozita të reja të këtij ligji sistemor. Për shkak të mosharmonizimit, dispozitat kalimtare të ligjit të ri janë ndryshuar dhe se ligji i vjetër do të vazhdojë implementimin në të gjitha procedurat të cilat nuk kanë hyrë të fuqi deri në korrik. Kjo do të ketë ndikim negativ në kohëzgjatjen e procedurave administrative dhe kontesteve.

Për avancime në reformën e administratës publike, lypset fshirë kufizimet e reja për qasje informacioneve, si dhe një raportim më i mirë i organeve mbikëqyrëse. Raporti ofron edhe rekomandimet mbi organizimin më efikas të shqyrtimeve publike, ofrimin e shërbimeve dhe menaxhimin me resurset njerëzore, sidomos në fushën e kufizimit të diskrecionit të kompetencave dhe të konfirmimit më objektiv të aftësive.

HYRJE

Ky raport tregon informacionet kyçe mbi reformën e administratës publike nga këndi i sektorit civil, përkatësisht organizatat të cilat në kuadër të projektit “Shoqëria civile për administratë të mirë “të shërbejë e meritojë”, të tentojë të rrisë rolin e shoqërisë civile në fushën e përcjelljes së reformës së administratës publike, edhe në këtë ndërlidhje, kontribuon vendosjes në praktikë menaxhimin e mirë në Malin e Zi.

Mali i Zi në reformë është inkuadruar në vitin 2003. Ndërkaq, problemet kyçe të cilat e rëndojnë reformën tonë edhe më tej janë të pranishme. Komisioni Evropian në Raportin e fundit mbi Malin e Zi, ka theksuar se problemin e politizimit dhe mbipopullimit edhe sot e kësaj dite rëndojnë administratën publike.¹ Qytetarët, në anën tjetër përballë besimit të mesëm, vlerësojnë se punësimi nëpërmjet lidhjeve mos efikasitetit dhe korrupsionit, janë probleme që ngarkojnë administratën tonë.²

Qeveria në korrik të vitit 2016 ka miratuar Strategjinë mbi Reformën e Administratës Publike për periudhën 2016-2020. Për periudhën paraprake, po ashtu ka ekzistuar Strategjia (ashq. AURUM për periudhën 2011-2015). Ndërkaq, pikërisht mungesa e mbikëqyrjes së gjithmbarshme të reformës së deritashme, shpie në rëndësinë e monitorimit të pavarur nga krahu i sektorit joqeveritar, i cili do të fokusohet në probleme kyçe në aspektin e pavarur a janë të përfshira në aktivitetet konkrete dhe qëllimet aktuale të Strategjisë.³

Kriteret themelore të cilat kemi aplikuar me rastin e grumbullimit të të dhënave, analizave të gjendjes të cilat janë prezantuar në raport, sa janë relevante disa gjëra për qytetarët, vlera e shtuar që organizatat e shoqërisë civile monitorojnë disa fusha, mund të realizohen si dhe qasja e të dhënave të duhura për hulumtime. Fushat në të cilat veçmas jemi fokusuar, janë: përgjegjësia e administratës, zhvillimi dhe koordinimi i politikave publike, punësimi në administratën publike dhe menaxhimi i gjithmbarshëm me resurset njerëzore, si dhe ofrimi i shërbimeve publike. Menaxhimi me financat publike paraqet një pikë të veçantë të dokumentit strategjik të Qeverisë⁴, por nëpërmjet aktiviteteve tjera në suazat e këtij projekti jemi marrë edhe me këtë çështje të rëndësishme.

Po ashtu, për dallim nga qasja e Qeverisë në procesin e monitorimit të reformës së administratës publike, shumicën e pyetjeve të cilat kanë të bëjnë me nivelin qendror e kemi analizuar edhe në rrafshin lokal, sidomos duke u përqendruar në Kryeqytet Podgoricë, dhe komunat Ulqin, Plevle dhe Kollashin.

¹ / Komisioni Evropian, Raporti mbi Malin e Zi, nëntor 2016.

² / Sipas një studimi të kryer nga Agjencia IPSOS, për nevojat e IA, çdo i pesti qytetarë konsideron se punësimi përmes lidhjeve është problemi më i madh (22%); një përçindje disi më e vogël e qytetarëve mendon se Administrata e Malit të Zi vuan nga jo efikasiteti (21%), ndërsa problemi i tretë me rend është korrupsioni që qytetarët e konsiderojnë si një barrë të madhe që më së shumti rëndon administratën.

³ / Teksti i Strategjisë përbëhet nga pjesa analitike dhe prioritetet kyçe. Qasja në hartimin e këtij raporti ishte fokusi mbi problemet e identifikuar, të cilët nuk janë pasqyruar në prioritetet deri në vitin 2020 dhe aktivitetet nga Plan Veprimi për periudhën e parë dy-vjeçare të zbatimit të Strategjisë.

⁴ / Programi i Reformës së Menaxhimit të Financave Publike 2016 - 2020, Ministria e Financave, Qeveria e Malit të Zi, nëntor 2015

Periudha që mbulon këtë raport ka të bëjë me vitin 2016 dhe në pesë muajt e parë të vitit 2017, në veçanti kur është fjala për proceset thelbësore – sjellja e vendimeve dhe zbatimi i masave kyçe. Qëllimi është që të shfaqet gjendja në fushat e ndërlidhura, si dhe periudhat ndërmjetëse në të cilat nuk ka pasur realizime të Strategjisë së Reformave Publike të Administratës. Duke u mbështetur në implementimin e dispozitave të vlefshme, të dhënat e nevojshme për një analizë më të thellë, janë grumbulluar duke pasur parasysh vitin 2016, me kërkesat për një qasje të lirë të informacioneve.

Të dhënat e grumbulluara janë edhe me analizën e dokumenteve dhe raporteve zyrtare të gjendjes në disa lëmenj, por edhe me intervistat e thella dhe gjysmë strukturuar me miratuesit të vendimeve, me grupin e fokusit të përfaqësuesve të organizatave joqeveritare dhe kërkesat për qasje të lirë të informacioneve. Po ashtu, me qëllim të monitorimit sa më gjithëpërfshirës, janë zbatuar dy hulumtime kuantitative – një sondazh i perceptimit të opinionit publik mbi administratën publike⁵ dhe sondazhi dhënia e shërbimeve publike në territorin e tetë komunave me metodën “vizituesi sekret”⁶.

Raporti është ndarë në pesë fusha. Në pjesën e parë, është dhënë një pasqyrë e përgjithshme e zbatimit të Strategjisë së Reformës së Administratës Publike. Pjesa e dytë përqendrohet në përgjegjësinë e administratës publike dhe sfidat kyçe në punën e Inspektimit të Administratës, realizimi i të drejtave të qasjes së lirë të informacioneve, dëshmitë gjyqësore të kontrollit të punës së administratës dhe të ndikimit të Ombudsmanit (Mbrotjtësit të të Drejtave dhe Lirive të Njeriut). Në pjesën e tretë është dhënë një vështrim i shërbimeve publike, në veçanti mbi perceptimin e kënaqësisë së shërbimeve të dhëna, përvojës së “vizituesve sekretë” organeve lokale dhe të administratës shtetërore në territorin e tetë komunave, përgatitjes së terrenit mbi ligjin e ri, Ligji mbi Procedurën Administrative dhe avancimi i dhënies së shërbimeve elektronike nëpërmjet portalit e-administratës.

Zhvillimi dhe koordinimi i politikave publike janë lëndë e analizës në pjesën e katërt të raportit me apostrofim pjesëmarrjen e qytetarëve dhe organizimi i shqyrtimeve publike. Pjesa e pestë fokuson sistemin e shërbimeve dhe problemeve me rastin e punësimeve të kuadrove në nivelin qendror dhe lokal. Përfundimet përmbledhin sfidat kyçe në fushën e reformave të administratës publike, të cilat shkarkohen prej njëres në fushën tjetër. Në fund japim edhe rekomandimet përkushtuar për një raportim më të mirë të organeve mbikëqyrëse, ndryshimeve të Ligjit mbi Qasjen e Lirë në Informacione në mënyrë që të largohen kufizimet e reja në aspektin e realizimit të transparencës, hartimin e katalogut të shërbimeve të organeve të administratës dhe zvogëlimi i autorizimeve diskrete dhe zbrazëtirave juridike me rastin e punësimit në administratën publike, dhe rekomandimet e avancimit shqyrtimeve publike.

5 / Perceptimi i Administratës Publike: Anketa e Opinionit Publik, Agjencia IPSOS për Institutin Alternativa, shkurt 2017

6 / Qytetarët në banak: Eksperiencia e vizitorëve të fshehtë, Agjencia IPSOS për Institutin Alternativa, mars 2017

PASQYRA E PËRGJITHME E ZBATIMIT TË STRATEGJISË

Gjatë 11 muajve të parë të zbatimit të Strategjisë, nuk janë plotësuar 60 % të aktiviteve në afatin e paraparë të Strategjisë (9 nga 15 të aktiviteve të parapara). Gjithsej të mbikëqyrura, janë plotësuar rreth 7% nga të gjithë aktivitetet e përshkruara (6 nga 82).

Nga 28 korriku 2016 e deri në qershor të vitit 2017, **janë plotësuar gjashtë aktivitetet të Strategjisë**: është miratuar Ligji mbi Kontestin Administrativ dhe ndryshimet e Ligjit mbi Qasjen e Lirë në Informacione, është jetësuar analiza e procedurave të posaçme administrative, janë miratuar planet kadrovike për vitin 2016, është përcaktuar pasaporta e indikatorëve mbi monitorimin e Strategjisë edhe është publikuar raporti i parë realizimit të tij.

Ndërkaq, në afatin e paraparë, **nuk janë realizuar 9 aktivitete**:

1. Hartimi i Analizës mbi pozitën e organizatave që ushtrojnë kompetencat publike;
2. Përgatitja e udhës së Hartës mbi implementimin e sistemit të "menaxhimit për rezultatet";
3. Zhvillimi i metodologjisë lidhur me mënyrën planifikimit dhe vlerësimi i të arrirave të politikave publike;
4. Ndryshimet e Rregullores së Qeverisë, me të cilën definoohen procedurat e planifikimit, koordinimit dhe monitorimit të politikave;
5. Fuqizimi i kapaciteteve të ministrisë së planifikimit dhe monitorimit të rezultateve të politikave publike;
6. Aprovimi i Programit të punës së Qeverisë për periudhën 2017-2020;
7. Përgatitjet e ndryshimeve dhe plotësimeve të Dekretit mbi procedurën dhe mënyrën zbatimit të shqyrtimit publik në procesin e përgatitjes së Ligjit dhe Dekretit, mbi mënyrën dhe procedurën e realizimit të bashkëpunimit të organeve shtetërore dhe organizatave joqeveritare;
8. Analiza rreth zbatimit të analizës së ndikimit rregullator të dispozitave (RIA);
9. Udhëzimi mbi zbatimin e analizës së ndikimit rregullator të dispozitave (RIA).

Aktivitetet e planifikuara për vitin e parë, siç vërehet nga pasqyrimi, kryesisht kanë të bëjnë me fushën e zhvillimit dhe koordinimit të politikave publike, por edhe mbi përgjegjësinë-nëpërmjet hartimit të analizës së pozitës së organizatave të cilat ushtrojnë kompetenca publike, që në fakt është aktivitet "i ngelur" nga Strategjia pararendëse, e vlershme për periudhën 2011-2015.⁷

⁷ / Strategjia e Reformës së Administratës Publike për Malin e Zi 2011-2016. "AURUM", Qeveria e Malit të Zi, Podgoricë, mars 2011.


Edhe pse Qeveria në raportin mbi zbatimin e Strategjisë ka pohuar se është përgatitur drafti i analizës përkatëse, si dhe Drafti i vendimit mbi mënyrën e përgatitjes dhe përmbajtjen e buxhetit programor ndaj kërkesës së kopjes së draftit⁸, Ministria e Administratës Publike dhe Ministria e Financave, është përgjegjës se nuk i disponon.

Në anën tjetër, siç do të ekspozohet me hapësirën tjetër të raportit, disa nga aktivitetet e realizuara, sidomos aprovimi i Ligjit mbi Qasjen e Lirë të Informacioneve, vlerësohen një hap pas krahasuar me gjendjen e mëparshme.

Mbi këto baza pjesa e mbetur e raportit është strukturuar në atë formë për të mundësuar ekspozimin e sfidave kyçe në fushat e përzgjedhura ndaj të dhënave mbi të cilat do të përgjigjeshin në pyetjet thelbësore a ka avancime në disa fusha të reformës së administratës publike.

⁸ / Raporti mbi zbatimin e Planit të Veprimit për Zbatimin e Strategjisë për Reformën e Administratës Publike për Malin e Zi 2016-2020, Qeveria e Malit të Zi, Podgoricë, mars 2017

PËRGJEGJSHMËRIA E ADMINISTRATËS



Në fushën e Përgjegjshmërisë së Administratës, në veçanti jemi përqendruar në punën e Inspektimit të Administratës, por edhe në kontrollin gjyqësor të administratës. Po ashtu në fokus është edhe ndikimi i Ombudsmanit lidhur me përgjegjësinë e administratës dhe realizimi i të drejtave për qasje të lirë në informata.

Inspektimi i administratës vuan nga mungesa e resurseve, numrit të inspektorëve, të cilët gjatë periudhës 2016 dhe 2017, ka numëruar prej 7 dhe 4. Mbikëqyrja e realizuar e inspektimit rezulton me një numër të vogël masash ndëshkuese. Fjala vjen, vetëm 4 % të kontrollimeve të bëra, rezulton me gjopa me të holla.

Në anën tjetër, kontrolli gjyqësor i administratës shënon një statistikë të palakueshme: mbi 50% të akteve të ministrive, ndaj të cilëve është iniciuar padi administrative gjatë vitit 2016, janë anuluar. Ndryshimet e Ligjit mbi Qasjen e Lirë në Informata nga marsi i vitit 2017 në “dyert e vogla” vendosin dëshminë e interesit të posaçëm të qasjes së procedurës së informacioneve.

Ndryshimet, po ashtu konfirmojnë kufizimet shtesë të qasjes së procedurës nëse kemi të bëjmë me “fshehtësinë tatimore” ose “veprimtarisë sekrete”. Mosrespektimi i ligjit dhe mosveprimi i organeve, është shkak i shumicës së denoncimeve të qytetarëve ndaj Administratës Publike, që i janë adresuar Ombudsmanit gjatë vitit 2016.

Në 33 denoncime nga fusha e administratës publike, janë dorëzuar edhe 12 deklarime të institucioneve mbi bazat e të cilave mund të konstatohet se është kënaqur e drejta e denoncuesve. Për denoncimet tjera vërehet mos përputhje e metodologjisë ndaj të cilës Ombudsmani ka raportuar mbi respektimin e rekomandimeve të tij.

INSPEKTIMI I ADMINISTRATËS: STATUSI KA NDRYSHUAR, PRITEN REZULTATET

Në korrik të vitit 2016 është miratuar Ligji mbi Inspektimin e Administratës, me qëllim që problemet e deri atëhershme në punën e inspektimit, të cilët sipas mendimit të propozuesve, kanë qenë pasoja të mungesës së dispozitave specifike sipas të cilave rregullohet kjo lëmi.



Nxjerrja e ligjit të posaçëm është në lidhje të ngushtë me Reformën e Procedurës Administrative⁹. Kompetencat e Inspektimit të Administratës, komfor këtij ligji kanë të

⁹ / Ligji i ri mbi procedurën administrative do të duhej të nis zbatimin në korrik 2017. Ky ligj, krahasuar me atë pararendës, nuk trajton në detaje, çështjet e mbikëqyrjes së inspektimit.

bëjnë me ushtrimin e monitorimit ndaj implementimit të dispozitave mbi procedurën administrative, mbi administratën shtetërore, dhe nëpunësit shtetëror dhe në fusha të tjera komfor ligjeve të posaçme¹⁰.

Gjatë vitit 2016, pas themelimit të Ministrisë së Re të Administratës Publike, është bërë riorganizimi Inspektimit Administrator, i cili që më herët nga Drejtoritë në kuadër të dikasterit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, është shndërruar në njësi të posaçme në suazat e Ministrisë së Administratës Publike. Kjo do të thotë se Inspektimi është bërë njësi e pavarur organizative që do të duhej të reflektojë pozitivisht në pavarësinë e punës së inspektorëve të administratës.

Mirëpo, numri i inspektorëve të administratës nuk është rritur, madje është zvogëluar nga 7 në 4 sish, sa kanë punuar në marsin e vitit 2017 në Ministrinë e Re të Administratës Publike. Dy inspektorët e transferuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, janë sistemuar në vende tjera të punës¹¹. Kjo nuk shkon në të mirë të mbrojtjes së inspektorëve në sistemin e nëpunësisë, meqë personat në mandatin shtatëvjeçar, vendet e tyre të punës nuk janë mbyllur. Përkundrazi, vendet e punës së inspektorëve administrativë janë sistemuar në numër më të madh në Ministrinë e Re edhe nuk ka arsytim mbi sistematizimin në vendet tjera të punës.

Po ashtu, në marsin e vitit 2017 është shkarkuar nga detyra krye inspektorja e administratës, një vit e gjashtë muaj pas emërimit në funksionin e mandatit shtatëvjeçar. Shkarkimi ka reflektuar me kundërthënie në opinion, për shkak të zërave se është për motive politike.¹²

Konkluzioni i Qeverisë me të cilin është dhënë pëlqimi mbi shkarkimin e krye inspektores është shënuar në nivelin "intern", që po ashtu nuk i kontribuon transparencës dhe besimit të opinionit në aspektin veprimit të Qeverisë dhe Ministrisë me këtë rast. Ndaj shkarkimit të krye inspektores së administratës, ndërkohë është iniciuar kontest administrativ pasi që ankesa është refuzuar.

MBIKËQYRJE E PAMJAFTUESHME E INSPEKTIMIT TË PËRGJITHSHËM

Nga Raporti i Ministrisë së Punëve të Brendshme mbi punën dhe gjendjen në sektorët e administratës, është e pamundur të sigurohen të dhëna të sigurta mbi vëllimin e inspektimit të realizuar të mbikëqyrjes. Përveç përshkrimit, në mënyrë precize dhe pasqyrim, nuk është dhënë mbikëqyrja e planifikuar e inspektimit dhe mbikëqyrja e rregullt e mbikëqyrjes (mbi bazat e planit pararendës). Fjala vjen, vetëm drejtpërdrejt, nga raporti i vitit 2016,

¹⁰ / Ligji mbi inspektimin administrativ, Fl. zyrtare e Malit të Zi nr. 042/16

¹¹ / Intervistë me Dragica Angjeliq, ish- krye inspektorin, realizuar më 13 qershor 2017, Podgoricë.

¹² / Ish-krye inspektorja në zgjedhjet në Podgoricë 2014, ka qenë kandidatë për këshilltare e Partisë Socialdemokrate, e cila në vitin 2016, është larguar nga koalicioni me partinë në pushtet, PDS. Në anën tjetër, njeri ndër shkaqe themelore për shkarkim sipas dokumentacionit, që IA ka pasur në disponim, ka qenë veprimi i Inspektoratit Administrativ në Komunën e Kollashinit, në krye të së cilës ka qenë përfaqësuesja e PSD.

mund të përfundohet se 12 njësi të administratave lokale nuk janë kontrolluar, gjatë vitit 2015, ndonëse inspektori mbikëqyrës e ka planifikuar.¹³

As gjatë vitit 2016 nuk është kontrolluar gjysma e planifikuar të njërive lokale të administratës. Inspektimet e planifikuara nuk janë bërë as në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Integriteteve Evropiane, as në Ministrinë e Financave (Drejtoria e Patundshmërisë të Podgoricës, njësitë rajonale në Herceg Novi, në Budva, Plavë). Po ashtu nuk janë shqyrtuar me kohë as iniciativat e dorëzuara – shqyrtimi për 40% të iniciativave është transferuar për vitin 2017 (400 nga 953).

Numri i institucioneve në të cilat është bërë mbikëqyrja e inspektimit sipas planifikimit të rregullt, mbi bazat e raporteve zyrtare përafërsisht ka nivelin e dy viteve kaluara – mbi 200 subjekte të mbikëqyrjes janë përfshirë me kontrollime inspektuese. Duhet theksuar se numri përfundimtar i subjekteve të mbikëqyrjes, nuk është i njohur meqë Inspektimi Administrativ ka në kompetencat e veta në mbikëqyrjen e realizimit të zbatimit të ligjeve të ndryshme për të cilat janë të obliguara edhe institucionet publike, shoqëritë ekonomike dhe shfrytëzuesit e tjerë të buxhetit shtetëror. Për vlerësimin e plotë të punës së inspektimit, është i nevojshëm regjistrimi i institucioneve dhe organeve mbi të cilat ushtrohet mbikëqyrje, i cili për momentin mungon.

Në anën tjetër, komfor procesverbaleve mbi kontrollimet e inspektimeve, të cilat janë publikuar në faqen internetit të Ministrisë së Punëve të Brendshme për periudhën 1 janar – 18 nëntor 2016, gjithsej 142, konkludohet se lëndën, llojin dhe organet e mbikëqyrura nga ana e Inspektimit të administratës nuk është i mjaftueshëm edhe gjithëpërfshirës¹⁴. Aq më shumë edhe për faktin se në një numër të vogël është bërë edhe inspektimi i rregullt (gjithsej në 25 raste). Po ashtu vetëm 25 inspektime e mbikëqyrje kemi të bëjmë me organet shtetërore, ndërsa në rastet tjera janë përfshirë komunat.

Mbi bazat e lëndën e mbikëqyrjes, në të shumtën e rasteve, inspektimi ka kontrolluar plotësimin të vendeve të punës dhe raportet e nëpunësve, në një masë të vogël heshtjen e administratës dhe veprimet specifike (dhënia e lejes së ndërtimit, letërnjoftimet dhe vizat). Është interesante për tu përmendur se mbi 18 % të procesverbaleve të publikuara kanë të bëjnë me Komunën e Kollashinit, në të cilën janë zhvilluar kryesisht inspektimet e jashtëzakonshme (komfor iniciativës) edhe inspektimet kontrolluese. Kjo komunë ka kaluar nëpërmjet zvogëlimit të dukshëm të vendeve të punës që e dëshmojnë iniciativat e shumta. Në anën tjetër, është fakti se pushteti në Komunë është rezultat i marrëveshjes së opozitës dhe ish-partnerit partisë në pushtet, PDS – Partisë Socialdemokrate, vë në spikamë mundësinë e politizimit të punës së Inspektimit të administratës sidomos në

¹³ / Komuna Danillovgrad, ajo rezidenciale e Cetinës, komuna Petnjica, Mojkovac, Bijelo Polje, Rozhajë, Zhablak, Guçi, Petnjica, Kotorri, Herceg Novi, Komuna urbane Tuz dhe Golubovci.

¹⁴ / Shënime të publikuara mbi kontrollimet inspektuese dhe monitorimet, të disponueshme në: http://www.mup.gov.me/rubrike/upravna_inspekcija?alphabet=lat&pageIndex=1

frymën e një numrit të madh të iniciativave të perealizuara gjatë vitit 2016, shtrohet pyetja e prioritetit të punës së inspektimeve dhe kriteret mbi bazat e të cilëve aprovohen planet e inspektorëve mbikëqyrës.

MASAT ADMINISTRATIVE

Numri dhe karakteri i mbikëqyrjes në nivelin vjetor është vetëm njeri nga dëshmitë e punës e Inspektimit administrativ. Fakti i cili në masën e rëndësishme përcakton ndikimin e saj në përgjegjësinë dhe ligjshmërinë e procedurës, janë masat e ndërmarra pas kontrollit inspektues. Masat administrative, të mund t'i shqiptojë Inspektimit administrativ ku përfshihen edhe gjobat në të holla, janë definuar me Ligjin mbi inspektimin e administratës dhe me ligjet e posaçme.

Gjatë vitit 2016, janë sjellë 49 aktvendime mbi urdhëresën e largimit të padrejtësive, janë shqiptuar 16 dënime në të holla, 11 masa administrative mbi ndalimin e ushtrimit të veprimtarisë, 15 kërkesa mbi iniciimin e procedurës për kundërvajtje si dhe pesë propozime mbi iniciimin e procedurës penale¹⁵. Me përvojën e publikimit të procesverbaleve mbi kontrollimet dhe mbikëqyrjen nga nëntori i vitit 2016, pas zgjedhjeve të përgjithshme, nuk është vazhduar ndonëse paraqet një kontribut të dukshëm të transparencës dhe përgjegjësisë së organeve të administratës dhe përgjegjësisë, nëpërmjet mundësisë më të lehtësuar të ndjekjes së procedurës së organit të administratës.

KONTROLLI GJYQËSOR I ADMINISTRATËS: STATISTIKË E PALAVDISHME

Statistika e Gjyqit administrative nuk tregon lëvdata mbi përgjegjësinë e administratës. Më shumë se gjysma e vendimeve të ministrisë, të denoncuar në Gjyqin administrativ, anulohen nga Gjyqi administrativ. Kur këto të dhëna shikohen në kontekstin e numrit të madh të kontesteve gjyqësore në kuadër të të cilave kërkohen kompensimi i dëmeve nga organet shtetërore dhe lokale të administratës para gjyqeve tjera, fitohet një dëshmi kyçe negative të cilësisë së administrimit në Malin e Zi.

Në fakt, sipas të dhënave mbi lëndët e përfunduara në Gjykatën administrative gjatë vitit 2016, gjithsej janë shqiptuar 2.173 aktvendime të konteksteve kundër ministrisë. Në 56% të rasteve janë asgjësuar vendimet e ministrisë ndaj të cilës është iniciuar kontesti administrativ (Shih fusnotën 1. ku figuron tabela me pasqyrën e numrit të lëndëve të përfunduara dhe vendimeve që janë anuluar të gjitha ministrive, veç e veç). Me këtë ka vazhduar trendi i numrit të madh kundër vendimeve të ministrive për çka Gjyqi administrativ ka tërhequr vërejtjen edhe në raportin e vitit 2015.¹⁶

¹⁵ / Raporti i Ministrisë së Punëve të Brendshme mbi punën dhe gjendjen në fushat e administratës për vitin 2016, Qeveria e Malit të Zi, Ministria e Punëve të Brendshme, mars 2017.

¹⁶ / Atëherë ishin gjithsej 1.888 ankesa. «Kur kemi parasysh fillimin e zbatimit të Ligjit mbi procedurën administrative, që parasheh rreth të gjerë kompetencash sipas të cilave vendosin ministrinë, (kjo) nuk shton numrin e kontesteve administrative *theksohet në raport.

Në volumin e papërgjegjshëm të procedurës administrative, dëshmojnë edhe të dhënat mbi numrin e kontesteve në të cilat organet shtetërore, si dhe përfaqësuesi ligjor, i përfaqëson Mbrojtësi i interesave pronësore-juridike. Më datën, 17.11.2016, **numri i përgjithshëm i lëndëve gjyqësore që ndodheshin te Mbrojtësi ishte 15.468**¹⁷. Në numrin më të madh të rasteve, Mbrojtësi i interesave pronësore-juridike, përfaqëson organet shtetërore si palë e akuzuar në kontestet e punës, duke mos përfillur numrin e kërkesave të akuzave, të pa bazë¹⁸.

Sipas kornizës ligjore, organet shtetërore kanë përgjegjësinë për dëmin që bëjnë të punësuarit. Ndërkaq, edhe pse Ligji mbi nëpunësit dhe eprorët, jep mundësinë që organi shtetëror të iniciojë denoncim kundër të punësuarit, i cili me veprimin e pavetëdijshëm ka dëmtuar organin, kjo mundësi nuk është shfrytëzuar¹⁹.

“Ekzistimi i interesit të posaçëm juridik mbi qasjen informacionit, “tatimor” dhe “veprimtarisë së fshehtë” – janë disa nga nocionet e reja të inkorporuar në ndërrimet e Ligjit mbi qasjen e lirë informacioneve. Këto ndryshime mund ta rrezikojnë transparencën e administratës sonë.

QASJE JO E LIRË E INFORMACIONEVE

Në maj të vitit 2017 kanë hyrë në fuqi ndryshimet e qasjes së lirë të informacioneve, të cilat te ne i sjell dhe përpunon parimin përdorimin e të dhënave dhe obligimin e organeve të prodhojnë, dorëzojnë dhe publikojnë bazat e tyre të dhënave në formatet e përkatëse. Përdorimi i serishëm i informacioneve është definuar me ligj të

cilat i disponon organi i pushtetit për qëllime komerciale dhe jo komerciale, të ndryshme nga destinacioni fillestar të cilat ato informacione kanë lindur.

Organi i pushtetit është i obliguar informacionet për përdorim të serishëm t’i publikojë në atë mënyrë që gjenden lehtë në formatet e hapura në nën portalet dhe portaleve të administratës elektronike.



Këto ndryshime sjellin pasigurinë juridike edhe janë të mbështetura në interpretimin e gabueshëm të Direktivës 2013/37/BE²⁰. Me ndryshimet ligjore përshkruhet, ndër të tjera, se kërkesa për përdorim të serishëm të informacioneve do të refuzohet

¹⁷ / Analiza mbi llojin dhe shkaqet e kontesteve, pozitën juridike, kompletimin kadrovik dhe teknik të Mbrojtësit të Interesave Pronësoro-Juridike, me propozimin e masave të avancimit të pozitës së Mbrojtësit për të mbrojtur pronën shtetërore, Qeveria e Malit të Zi, 7 shkurt 2017, Podgoricë.

¹⁸ / Njëjtë.

¹⁹ / Përgjigje në kërkesën për qasje të lirë të informacioneve.

²⁰ / Direktiva 2013/37/BE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, 26 qershor 2013 mbi ndërrimet e Direktivës, 2003/98/BE mbi përdorimin e serishëm të sektorit publik, Gazeta zyrtare e BE, L 175/1, e disponueshme në://eur-lex.europa.eu/legal-content/HR/TXT/PDF/?uri=CELEX:32013L0037&from=EN

nëse dorëzuesi i kërkesës duhet të dëshmojë ekzistimin e interesit të posaçëm juridik për qasje informacioneve. Deri më tash dorëzuesit e kërkesave nuk kanë pasur nevojë të dëshmojnë interesin për qasje të informacioneve që është zgjidhje e mirë, sepse në të kundërtën, nga njeri rast në tjetrin, organet e pushtetit do ta vlerësonin a është interesi i arsyeshëm apo jo. Megjithatë, me vendosjen e formulimit të “interetit të posaçëm juridik” do të mund ta rikthente këtë praktikë të mirë, që nuk është në frymën rregulluese të BE në fushën e qasjes dhe të përdorimit të serishëm të informacioneve. Në fakt, Direktiva BE ka dal pikërisht si përgjigje në pasigurinë juridike të cilën e ka sjellë përvoja e ndryshme lidhur me zgjidhjen e kërkesave për qasje dhe përdorim të serishëm të informacioneve. Në Malin e Zi, ndërkaq kemi një gjendje tjetër, që me **rregullimin e përdorimit të serishëm rrezikohet qasja e lirë informacioneve, me obligimin e dorëzuesit të kërkesës që të dëshmojë se ekzistimin e interesit të veçantë për qasje informacionit.**

Përveç dëshmisë së të ashtuquajturit interes i posaçëm juridik për qasje informacionit, si bazë për refuzimin e qasjes, janë inkorporuar edhe shumë baza të gjera me të cilat krijohet hapësirë e rëndësishme për refuzim të pabazë të qasjes. Me ndryshimin për përdorim të serishëm të të dhënave inkorporohet edhe i ashtuquajturi “shpenzimet shtesë të qasjes”, ku me dispozita të paqarta është lënë një hapësirë e madhe për keqpërdorime të pagesave për përdorim të serishëm të informacioneve nga ana e organeve të pushtetit.

Ndryshimet e Ligjit mbi qasjen e lirë të informacioneve edhe pse shqyrtimi publik ka qenë i kufizuar edhe pse diskutimi publik ka qenë vetëm mbi segmentin e përdorimit të përsëritur të informacioneve, njohjes dhe kufizimeve shtesë për qasjen e lirë të informacioneve. Përcaktimi është se organi i pushtetit mund ta kufizojë

Në çdo të dytën kërkesë adresuar organeve të pushtetit vitin 2016 ka pasur me ankesë Agjencisë për mbrojtjen e të dhënave personale dhe qasje të lirë informacioneve.

qasjen informacionit, ose pjesën e informacionit nëse kemi të bëjmë me **“veprimtarinë” ose i “sekretin tatimor”**. Me këtë interesi privat vendoset mbi atë publik, e që nuk është në frymën e qasjes së informacioneve të rëndësishme publike. Organet e pushtetit “nuk kanë punë” të cilat do të duhej të fshehën nga publiku, edhe këto ndryshime mund të interpretohen si diçka në drejtim të interesave private të kompanisë e jo në të drejtën e qytetarëve që të jenë në dijeni se për çfarë shpenzohet paraja publike.

MË SHUMË KËRKESA, GJITHNJË MË PAK INFORMACIONE

Gjatë vitit 2016 numri i kërkesave të arritura për qasje të lirë informacioneve në adresë të organeve të pushtetit është rritur gati në 2.000 (nga 4.434 në 6.426).

Është shënuar edhe trendi i kërkesave të refuzuara për afro 7% (në vitin 2016 kjo përqindje ishte 24.3%, në vitin 2015 17.7%), si dhe rritja e përqindjes së rasteve të heshtjes se

administratës për mbi 100 (gjatë vitit 2016 është shënuar një heshtje administrative në 997, ndërsa gjatë vitit 2015 në 897 raste)²¹.

Në çdo të dytën kërkesë është bërë ankesë, sepse Agjencia gjatë vitit 2016, ka marrë 3556 ankesa. Gjatë vitit 2017 ka vazhduar trendi i rritjes: nga fillimi i vitit e deri në gjysmën e majit, numri i ankesave të bëra Agjencisë është 1.718²². Në anën tjetër, është një numër i madh të kontesteve administrative kundër Agjencisë: gjatë vitit 2016 543 denoncime janë dorëzuar në Gjyqin administrativ lidhur me vendimet e Këshillit të Agjencisë. Në të njëjtën periudhë, gjyqi ka sjellë 345 mendime dhe **mbi 83% të rasteve ka miratuar denoncimet kundër Agjencisë (288 vendime)**.

Dy shkaqe kryesore të përqindjes së lartë të denoncimeve të miratuara kundër Agjencisë: heshtja, përkatësisht mosdhënia e përgjigjes të këtij institucioni në ankesat e bëra kundër vendimeve të organit të shkallës së parë dhe mospërputhjes së interpretimit meritovendimit përfundimtar mbi bazat e ankesave midis Agjencisë dhe Gjyqit Administrativ. Në fakt, 190 denoncime kundër Agjencisë janë miratuar për shkak se, sipas ankesave, ky institucion ka kërkuar nga Inspektorati i administratës kontrollimin e të veprimtarisë së kancelarisë, për çka inspektorati nuk është përgjigjur në me kohë. Si pasojë e gjithë kësaj, Agjencia nuk ka dhënë përgjigje në apostrofimet e ankesave. Në anën tjetër, denoncimet tjera janë miratuar për faktin se Agjencia më në fund ka urdhëruar organin e shkallës së parë që të sigurojë qasjen informacioneve të kërkuara. Gjyqi administrative konsideron se vetë Agjencia është dashur të sigurojë qasjen e kërkuara.²³

INJORIMI I DETYRIMEVE PRO AKTIVE TË PUBLIKIMIT

Publikimi proaktiv i informacioneve me interes publik, që është obligim ligjor për të gjithë organet e administratës, është një fushë problematike²⁴. Deri në vitin 2017 edhe pse ka pasur kompetencë ligjore për iniciimin e procedurës për kundërvajtje. Agjencia nuk e ka ushtruar mbikëqyren e inspektimit në këtë fushë. Nuk ka pasur as kërkesa për të iniciuar procedurë për kundërvajtje kundër organit i cili nuk përfillë detyrimin mbi publikimin pro aktiv të informacioneve, edhe pse sektori joqeveritar ka pasur nisma në adresë të Agjencisë lidhur me këtë çështje.²⁵

²¹ / Raporti mbi gjendjen e mbrojtjes së të dhënave personale dhe qasjes së informacioneve 2016, Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Qasjes së Lirë në Informacione, Podgoricë, mars 2017. Raporti mbi gjendjen e mbrojtjes së të dhënave personale dhe gjendja e qasjes së informacioneve për vitin 2015, Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Qasjes së Lirë në Informacione, Podgoricë, mars 2016, në disponim në: <http://www.azlp.me/me/izvjestaji>

²² / Intervistë me Çedomir Mitroviqin, drejtorin e Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Qasjes së Lirë në Informata, Muhamed Gjokajn, kryetarin e Këshillit APDHP, Bilana Bozhiq, eproren e Sektorit për Qasje në Informata APDHP dhe Nenad Durkoviqin, epror i Sektorit të Regjistrimit dhe Sistemit të informacionit, mbajtur më 12 maj 2017 në zyrat e Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Qasjes së Lirë në Informata

²³ / Intervistë me Branko Llakoçeviqin, kryetarin e Gjykatës Administrative, më 10 maj në zyrat e Gjykatës Administrative.

²⁴ / Obligimet e publikimit pro aktiv të informacioneve të rëndësisë publike, janë definuar me nenin 12 të Ligjit për Qasjen e Lirë në Informacione.

²⁵ / Fokus grupi me përfaqësuesit e sektorit civil.

Gjatë vitit 2017, Agjencia ka marrë detyrë për mbikëqyrjen e inspektimit në Ministri lidhur me publikimin pro aktiv, pas ndryshimeve të Rregullores mbi organizimin dhe sistematizimin e brendshëm, në fillim të vitit janë krijuar parakushtet në këtë ndërlidhje. Mirëpo, me planin e mbikëqyrjes plotësisht janë anashkaluar administratat lokale, edhe përkundër faktit se Komuna e Gucisë nuk ka stacion Interneti, thekson nevojën e monitorimit efikas të pro aktivitetit të transparencës së organit të administratës lokale të nivelit lokal. Deri në gjysmën e majit të vitit 2017, Agjencia ka ushtruar mbikëqyrjen e inspektimit në gjashtë ministri. Kapitujt problematikë, të cilat janë vërejtur gjatë mbikëqyrjes janë defekti i sajteve, d.m.th. pamundësia për të gjenden disa informacione, madje edhe kur janë publikuar. Azhurnimi i të dhënave nga fusha e qasjes pro aktive, po ashtu është problem, sepse, p.sh. disa ministri herën e fundit në vitin 2013 kanë azhurnuar qasjen e lirë të informacioneve, edhe pse janë të obliguara këtë veprim ta bëjnë një herë në vit.²⁶

PROCEDIMI I ADMINISTRATËS TE OMBUDSMANI: (MOS)PROCEDIM I KEQ

Ombudsmani ka raportuar se gjatë vitit 2016 ka pasur 340 ankesa për punën e administratës publike. Nga kjo, rreth 10% rekomandime të qëllimshme për organet administrative, ndërsa në më shumë se 42% të ankesave për shkelje u eliminuan gjatë procedurës, gjë që mbështet pretendimin se Ombudsmani ende ka një qasje pragmatike, që reflektohet në përpjekjet për të eliminuar dëmtimin gjatë procedurës.²⁷


Në faqen e Internetit të Ombudsmanit, mund të gjenden mendimet me rekomandimet sipas lëndëve të punës, duke përfshirë edhe administratën publike²⁸. Po ashtu në raportin mbi punën për vitin 2016, është prezantuar vështrimi mbi mosplotësimin e rekomandimeve, duke i njehsuar veç e veç. Në tabelën 1 është publikuar vëllimi i lëndëve të ankesave Ombudsmanit gjatë vitit 2016, të cilat në të shumtën kanë të bëjnë me mosrespektimin dhe mosrealizimin e obligimeve të organit të administratës.

²⁶ / Intervistë me Çedomir Mitroviqin, drejtorin e Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Qasjes së Lirë në Informata, Muhamed Gjokajn, kryetarin e Këshillit APDHP, Bilana Bozhiq, eproren e Sektorit për Qasje në Informata APDHP dhe Nenad Durkoviqin, epror i Sektorit të Regjistrimit dhe Sistemit të informacionit, mbajtur më 12 maj 2017 në zyrat e Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Qasjes së Lirë në Informata

²⁷ / Në raportet e misionëve të ekspertëve të Bashkimit Evropian në lidhje me Ombudspersonin, është vërejtur kjo qasje pragmatike, shiko: Peer-Review on the Rule of Law Fundamental Rights – The Ombudsman Institution Podgorica 24-27 March 2015 Peer Assessment Report (Follow-up) Klavs Kinnerup Hede, Ph.d. May 2015

²⁸ / <http://www.ombudsman.co.me/index.php>

Tabela 1. Shkaqet e ankesës kundër administratës publike, të cilat i ka zgjidhur Ombudmani gjatë vitit 2016. (Burimi: Raporti mbi punën e Ombudsmanit për vitin 2016)



Sipas sistemit të tanishëm të raportimit, nga 33 mendimet e sjella gjatë vitit 2016, së bashku me 41 rekomandimet të cilat kanë të bëjnë me administratën publike **nuk janë përfillur 7 rekomandime. Pesë prej tyre kanë të bëjnë qasjen e lirë të informacioneve.**

Ministria e Komunikacionit dhe Detarisë nuk i ka përfillur katër propozime sepse nuk është përgjigjur në vendimin e Gjykatës administrative edhe kërkesën për qasje të lirë informacioneve organizatës joqeveritare MANS që në janar, përkatësisht të marsit të vitit 2014. Një rekomandim i papërfillur ka të bëjë me Agjencinë për mbrojtjen të dhënave personale dhe qasjes së lirë informacioneve për të cilin kërkohet nxjerrja e vendimit mbi bazat e ankesës së MANS-it, të deklaruar lidhur me Ministrinë e zhvillimit të qëndrueshëm dhe të Turizmit me rastin e kërkesës për qasje të lirë informacioneve në maj të vitit 2015. Dy rekomandimet kanë të bëjnë me Komisionin për nevojat banesore të ndërmarrjes “Čistoća” Kryeqytet-Podgoricë nga e cila kërkohet përfillja e vendimit gjyqësor lidhur me ndarjen e banesave dhe në Ministrinë e Mbrojtjes të cilës i bëhet apel që të nënshkruaj kontratë mbi marrjen me qira të banesës me një person fizik.

Disa rekomandime të paplotësuara kanë të bëjnë me cenimin e të drejtave që është bërë para dy vjetëve e sa. Ndërkaq, Ombudsmani deri më tash nuk e ka shfrytëzuar mundësinë që të iniciojë procedurë disiplinore dhe kundërvajtje, ndaj personave lidhur me cenimin apo mos cenimin e të drejtave njerëzore, përkatësisht kundër individëve të cilët nuk veprojnë sipas kërkesës së Mbrojtjesit në afatin e caktuar.²⁹

Edhe pse është vlerësim pozitiv fakti se të gjithë mendimet së bashku me rekomandime botohen në faqen, opinionit i mohohet e drejta për një pasqyrim të plotë në mendimet e Ombudsmanit ku mungojnë rekomandimet, përkatësisht kur nuk është përcaktuar

²⁹ / Përgjigja e kërkesës për qasje të lirë në informacion

shkelja e të drejtave. Një numër përkatës i “mendimeve tjera” publikohen, por nuk janë përfshirë të gjitha mendimet tjera, që ndikojnë negativisht të mundësisë të vlerësimit të gjithmbarshëm të punës institucionit të krahut të opinionit të interesuar.

SI DUHET RAPORTUAR MBI PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE?

Raportimi i Ombudsmanit lidhur me plotësimin ose pjesërisht të plotësuar të rekomandimeve nuk mjafton në hollësi. Përveç informacioneve parimore se, rekomandimi është plotësuar, ose pjesërisht e plotësuar, në raportin vjetor mbi punën, nuk është arsyetuar se në cilët segmente edhe në çfarë mënyre rekomandimi është plotësuar.

Fjala vjen, pohohet se pjesërisht është plotësuar rekomandimi Ministrisë së Financave se analiza e mundësive të financimit mbi bazat e barabarta të organizatave të luftëtarëve dhe mbi këtë çështje në afatin më të shkurtër të realizojë konsultime me të gjitha organizatat e luftëtarëve me qëllim të gjetjes së modelit optimal të financimit. Ndërkaq, është e paqartë se në cilën pjesë ky rekomandim është plotësuar pjesërisht- a janë realizuar konsultimet është përcaktuar modeli i financimit, ose një variant i tretë.

“Të gjitha vendimet që do të aprovohen (...) do të përmbajnë arsyetimin me fakte të qarta dhe të mjaftueshme për vendim, (...) edhe do t`u dorëzohet të gjithë pjesëmarrësve në procedurë eksperiencën përkatëse mbi mjetet juridike”. -IP “Komanski most” në përgjigjen e rekomandimit të Ombudsmanit.

Po ashtu, nga raporti i Ombudsmanit nuk është e qartë se në cilën mënyrë janë plotësuar rekomandimet e dhëna. Instituti alternativa me një kërkesë mbi qasjen e lirë informacioneve ka kërkuar kopjen e informacionit / raportit / e deklarimit me dokumentin përcjellës, të cilat organet nga sistemi i administratës shtetërore dhe qeverisjes lokale, gjatë vitit 2016 dhe 2017, i kanë dorëzuar Mbrojtësit lidhur me plotësimin e rekomandimeve të dhëna.

Nga dokumentacioni të cilin e kemi grumbulluar, arrihet përfundimi se nuk ekziston metodologji e unifikuar mbi bazat e së cilës mund të konkludohet se rekomandimi përkatës është plotësuar. Kështu, fjala vjen, **në 33 ankesa, të cilat sillen në administratën publike, dhe rekomandimet të e dhëna gjatë vitit 2016, në këtë fushë adresuar 12 deklarime të institucionit mbi bazat e së cilave është e mundur që të konkludohet se është realizuar e drejta e dorëzuesit të ankesës** (p.sh. ankesa i është adresuar organit kompetent, është bërë procesverbali, janë hequr barrierat teknike i është përcjellë organit kompetent, është hartuar ranglista e re, është sjell vendimi i ri, aktvendimi, është realizuar e drejta e përgjigjes etj.

Në raste të caktuara, ndonëse Ombudsmani ka raportuar se rekomandimi është plotësuar, shtron pyetjen a është realizuar rekomandimi lidhur me shkeljen e të drejtave, për çfarë

qytetarët i janë drejtuar këtij institucioni. P.sh. Ombudsmani i ka propozuar Komisionit për kthim dhe dëmshpërblim në Bijello Pole, për një rast të marrë vendim të mbështetur në ligj për shkak të tej zgjatjes së paarsyeshëm të procedurës. Komisioni e ka marrë vendimin në shtator të vitit 2016. Ndërkaq, në këtë vendim ka pasuar ankesa komisionit të shkallës së dytë në Ministrinë e Financave edhe procedura është në shqyrtim e sipër. Nuk është plotësisht e sigurt se është mbështetur në ligj. **Po ashtu, në mendimet me rekomandime ndaj 15 ankesave të deponuara në punën e organit të administratës publike nga (gjithsej 33), nuk kanë arritur deklarime.** Në këto raste, procedura kryhet me sigurimin e informacioneve të duhura në një mënyrë tjetër, por kjo nuk është prezantuar në raport.

SHPJEGIMI I LIGJIT SI REKOMANDIM

Në parim, analiza e vlerësimeve me rekomandime që kanë të bëjnë me administratën publike, tregon se të shumtën ajo përbëhet nga **thirrja që organet kompetente të përfillin dispozitat dhe standardet ndërkombëtare që kushtëzojnë me papërgjegjësinë rreth veprimit të organeve të administratës.**

Fjala vjen, në ankesën rreth cenimit me rastin e shpalljes për vend pune në entin publik “Komanski most”, qytetarja ka theksuar shkelje të rëndësishme të procedurës, të cilat i pamundësojnë që në mënyrë të barabartë të marrë pjesë në të.

Në deklaratë përfaqësuesit e këtij enti kanë potencuar se në veprimet e ardhshme me rastin e marrjes së vendimit në shpalljet publike ose në momente të ngjashme do të veprojnë komfor dispozitave ligjore: “Të gjitha vendimet që do të merren në këtë çështje, do të përmbajë arsyetime të qarta dhe të mjaftueshme për vendim (...) edhe do t’u adresohet të gjithë pjesëmarrësve në procedurë me përvojën përkatëse mbi mjetet juridike.” Domosdoshmëria e potenconit në dispozitat ligjore të organeve të cilët janë kompetentë t’i zbatojnë, flet mbi papërgjegjësinë e zgjeruar në administratën publike.

Drejtëpërdrejt ndikon edhe në mënyrë të kufizuar në punën e Ombudsmanit, i cili kryesisht me elementet e shkeljes ligjore.

OFRIMI I SHËRBIMEVE

Në fushën e ofrimit të shërbimeve jemi fokusuar në perceptimin e cilësisë së shërbimeve publike, qasjes së informacioneve mbi dhënin e shërbimeve në nivelin lokal dhe shtetëror, cilësi dhe nivel ofrimit të shërbimeve elektronike, si dhe në efektet e pritura të zbatimit të Ligjit të ri mbi procedurën administrative.

Qytetarët shërbimeve të administratës publike i japin notë mesatare: përafërsisht është një përqindje të kënaqur edhe të pakënaqur të qytetarëve me ofrimin e shërbimeve publike edhe gjeneron rreth 40%.

Deri në muajin mars 2017, Kuvendi s'i ka miratuar dot 50 ligje të posaçme të cilët do të duhej të jenë të harmonizuara me Ligjin e ri mbi Procedurën Administrative. Për shkak të vonesës, ndryshimi i mëhershëm i dispozitave për të gjitha procedurat, të cilat nuk kanë përfunduar me hyrje në fuqi deri në fillimin e jetësimit të Ligjit të ri, të implementimit të dispozitave të reja.


Për dallim të tij, një numër i madh i procedurave të filluara, do të realizohen sipas Ligjit të vjetër që do të prolongonte veprimet e pritura të institutit të ri.

Numri i shërbimeve elektronike të disponueshme në portalin e-administratës, është rritur mbi 130 shërbime nga fillimi i jetësimit të Strategjisë. Çmimi i certifikatës digjitale për qytetarë dhe persona juridikë, arrin deri në 110 euro, është një barrierë si pasojë e shumës që duhet ndahet në mënyrë që shfrytëzuesit të mund të identifikohen me rastin e shfrytëzimit të shërbimeve të avancuara.

PERCEPTIMI I CILËSISË SË SHËRBIMEVE PUBLIKE

Komfor rezultateve të sondazhit të opinionit publik, të cilin për nevojat e projektit e ka realizuar Agjencia IPSOS, është i ngjashëm numri i qytetarëve të kënaqur me shërbimet e administratës publike (40%) edhe ata të pakënaqurit (44%). Megjithatë, numri më i madh është i atyre që nuk janë të kënaqur (12%), se sa ata që janë shumë të kënaqur (7%). Meshkujt shpesh janë të pakënaqur (50%) se sa femrat (38%), ndërsa qytetarët, të cilët kanë përvojë me administratën lokale, rëndom kanë qëndrim të skajshëm negativ (17%).

Grafiku 2: Sa jeni të kënaqur me shërbimet në zyrat e administratës publike? Baza: Popullariteti i gjithmbarshëm i qëllimit (Burimi: sondazhi i opinionit publik mbi perceptimin e administratës publike, Agjencia Ipsos, shkurt 2017)



Joefikasiteti është motivi më i shpeshtë i pakënaqësisë (21% përzgjedhja e parë, 33% të gjithë të përmendurit), pason pritja në radhë (13%, 30%), nevoja e ekzistimit të "lidhjes" (11%, 24%), procedura e komplikuar (9%, 24%), raporti i nëpunësit (6%, 18%), orar i shkurtër i punës me palë (4%, 14%) mungesa e informacioneve (5%, 13%). Lidhjet, gjykuar sipas perceptimit të qytetarëve, luajnë rolin më kryesor në komunat veriore (zgjedhja e parë 17% e qytetarëve), ndërsa në Podgoricë pritjet e gjata në radhë (25%). Në komunat në jug shpesh përmendet mos efikasiteti i administratës (45%).

Gati gjysma e qytetarëve mendojnë se kërkesat dërguar administratës publike zgjidhen shumë ngadalë (49%). Qytetarë janë të ndarë rreth çmimit të shërbimeve të administratës publike, njëra palë mendon se çmimet janë të pranueshme, (29%) por ana tjetër, e ngjashme të parën, konsideron se çmimet janë të larta (25%) dhe se lartësia e çmimeve varet nga shërbimet (29%). Qytetarët me të ardhurat më të ulëta (32%), të papunësuarit (33%) edhe nga komunat e madhësisë së mesme (30%) shpesh vlerësojnë se çmimet janë shumë të larta, ndërsa numri më i madh i qytetarëve që kanë pasur eksperiencë me administratën publike mendon se çmimet variojnë nga njeri shërbim në tjetrin (38%).




VIZITUESI SEKRET NË NIVELIN LOKAL: PËRVOJA NGA SPORTELI

Perceptimet e qytetarëve të marra mbi bazat e hulumtimeve kuantitative të CAPI (Computer Assisted Personal Interviewing) me teknikë mostrën reprezentative me 1027 qytetarë të Malit të Zi, të gërshetuar me gjendjen në terren për nevojat e monitorimit të reformës së administratës publike, është realizuar sondazhi i shërbimeve publike me metodën "vizituesi sekret".

"Teknika e vizituesit sekret /shfrytëzuesit" (ang. Mystery shopper) do të thotë shkuarja e anketuesve të përgatitur specialë në institucione për të vlerësuar parametra të ndryshme të shërbimeve të cilat ofrojnë ato institucione.

Në hulumtimet e ndara "vizituesi sekret" i kanë vlerësuar më mirë shërbimet e dhëna se sa kanë bërë qytetarët në hulumtimin e opinionit publik.

Krahas dukshmërisë më të madhe të përvojave të këqija, të cilat mund të „ngjyrosin“ vlerësimin mbi shërbimet e administratës publike, arsye për një vlerësim më të mirë



është hulumtimi me metodën e vizituesit sekret, fokusi është përqendruar ofrimin e informacioneve lidhur me shërbimet e përzgjedhura. Qytetarët e pakënaqur me shërbimet e administratës publike, kryesisht janë përqendruar në mos efikasitetin e zgjidhjes së kërkesave, ndërlidhshmëria e procedurave dhe nevoja e shfrytëzimit të njohjes për punë të zgjidhjes së kërkesës - e, të gjitha këto aspekte të cilët nuk janë mbuluar me metodën e hulumtimit teknik, "vizituesi sekret".

Shërbimet që kemi përzgjedhur për eksplorime me metodën "vizituesi sekret", që për herë të parë realizohet në Malin e Zi, janë:

- Lëshimi i dokumenteve personale;
- Kurorëzimi i martesës;
- Lëshimi i lejes së ndërtimit;
- Regjistrimi i prodhimeve bujqësore.³⁰

Shërbimet e administratës publike janë matur në tre aspekte: shërbimet e arritshme, profesionalizmi dhe mirëpritja e nëpunësit, cilësia e përgjigja e nëpunësit.³¹ Puna në terren është realizuar në tetë komuna: Plevle, Kollashin, Uqin, Podgoricë, Nikshiq, Bijello Pole, Danilovgrad dhe Tivar.³²

30 / Pasqyra detaje e "skenarëve" të përzgjedhur dhe analizës, është dhënë edhe Shtojcës 2, si dhe në raportin e ndarë mbi këtë hulumtim: Qytetarët në sportel, Përvojat e vizituesve sekretë, Agjencia IPSOS për nevojat e Institutit alternativa, mars 2017.


31 / Aspekti i arritjes së shërbimeve qytetarëve është matur me numrin e sporteleve aktivë, zyrave të adaptuara për personat me invaliditet, rrugën adekuate të shfrytëzuesve në hyrje të institucionit dhe pritjet e gjata në radhë. Aspekti i profesionalizmit dhe mirësjelljes së nëpunësve, është matur me përkushtimin dhe korrektesinë e nëpunësve, duke përfshirë edhe kyçjen e nëpunësve në bisedë, me komunikim të qartë, me dhënie informacioneve të qarta dhe të plota edhe faktin se ka përshëndetur në mënyrë adekuate vizituesin në fillim dhe në fund të takimit. Aspekti i cilësisë i përgjigjes së nëpunësit mbi kërkesën specifike është matur me numrin e nëpunësve, të cilët janë përgjigjur në kërkesën, udhëzimin në institucione tjera adekuate, në pyetjet adekuate të shtruara vizituesit (në mënyrë që të përgjigjet më mirë në kërkesën e tij), theksimin e dokumenteve të duhura (dhe rezyrenë e tyre në fund të bisedës) dhe hapat e mëtejshëm, dëshminë e të gjitha shpenzimeve lidhur me kërkesën dhe dhënie e të gjitha informacioneve të duhura të ndërlidhura me kërkesën.

32 / Është me rëndësi të përmendet se nuk është fjala mbi shkakun reprezentativ, ndonëse, këto të dhëna, japin një pasqyrë të mirë të gjendjes në institucione sipas parametrave të apostrofuara, nuk mund të prezantohen detyrimisht të gjitha organet e administratës në Malin e Zi. Po ashtu duhet përmendur se për një skenar në një komunë është realizuar me nga një vizitë, edhe nuk është e mundur që të përgjithësohet se kështu është dhënia e shërbimeve nga ana e të gjithë nëpunësve me rastin e të gjitha ardhjeve të qytetarëve në institucion

Cilësia e shërbimeve të administratës publike është në nivelin e njëjtë në komunat e përfshira në sondazh edhe kualiteti i shërbimeve është vlerësuar me notë më të mirë në komunën e Ulqinit (80% të standardeve të shërbimeve të plotësuara), ndërsa, më të dobëta janë në komunën e Nikshiqit (55%). Nota mesatare e cilësisë së shërbimeve të administratës publike për të gjithë të anketuarit arrin në 73% të standardeve të plotësuara.

Në shkallë prej 1 deri 10, vlerësoni përvojat tuaja me këto institucione, ku 1 do të thotë se nuk ju ka pëlqyer aspak kurse 10 do të thotë se ju ka pëlqyer shumë.

Baza: të gjitha vizitat (N=32)



Në parim, profesionalizmi dhe mirësjellja e përgjithshme e nëpunësve shikuar nga ndërlidhja e përgjithshme, është shumë pozitive, vlerësuar në shumicën e komunave të pyetura. Shërbimet adekuate, kanë marrë nota më të dobëta. Shumë institucioneve u mungon qasja adekuate për personat me invaliditet, shpesh edhe kur ekziston trapazani ose ashensori në katin përdhes, hapësira nuk u është përshtatur personave me të mbeta fizike. P.sh. nuk u mundësohet qasja kateve tjera. Po ashtu, më dobët është notuar edhe cilësia e përgjigjes së nëpunësit në kërkesat specifike – nëpunësit në raste të rralla kanë shtruar pyetjet e domosdoshme për të njohur nevojat e qytetarëve dhe në harmoni me të, kanë dëshmuar cilët dokumente u lypsen ose sa do të jenë shpenzimet e grumbullimit të dokumenteve të theksuara.

Prandaj, puna joadekuate e nëpunësit, i cili vëren një pjesë të qytetarëve në fushën e hulumtimit të opinionit publik, deri në një masë, janë konfirmuar lëshimet në cilësinë e shërbimeve të administratës publike shikuar nga konteksti i vizitave institucioneve (mungesa e duhur e dokumenteve të nevojshme dhe të shpenzimeve të parashikuara

deri në finale të kërkesës si dhe mungesa e përshëndetjes së klientit në fund të bisedës, dhënia, mungesa e kycjes në bisedë, dhe dhënia e informacioneve jo të sakta).

PËRGATITJA E „TERRENIT” PËR LIGJIN E RI MBI ADMINISTRATËN PUBLIKE

Ligji sistemor, nga i cili më së shumti varet efikasiteti i procedimit administrativ, me këtë edhe shërbimet, është Ligji i ri i Procedurës Administrative, i cili nis implementimin nga data 1 korrik 2017.³³

Risi kyçe të cilat i sjell ky ligj edhe nga të cilat pritet avancimi i dhënies së shërbimeve, ndër të tjera janë:³⁴

- Inkorporimi i parimeve të siguruara mbi bazat e detyrës zyrtare; me qëllim që të zvogëlohet ngarkesa e qytetarëve me rastin e realizimit të drejtave në administratën publike, shpesh ata duhet t'i grumbullojnë vetë dokumentacionin nga institucione të ndryshme, organet juridike–publike janë të obliguar që vetë nga organet tjera të sigurojnë dokumentet e duhura;
- Komunikimi elektronik - dorëzimi i parashtresës dhe dërgimi nëpërmjet rrugës elektronike;
- Pengimi i të ashtuquajturit efektit ping-pong - d.m.th. përsëritja e procedurës në kohëzgjatje pa afat, transferimi i obligimeve organit të shkallës së dytë, nëse sipas ankesës një herë e ka anuluar vendimin e shkallës së parë, ndërkaq pala përsërit procedimin edhe vetë ta zgjidh çështjen administrative.

Ligji i ri mbi Procedimin Administrativ duhet të avancojë edhe raportimin mbi procedurën administrative edhe me këtë në kompetencat e Ministrisë së Administratës Publike vendoset grumbullimi i të gjithë raporteve mbi procedimin organeve të administratës shtetërore, përkatësisht të vetëqeverisjes lokale deri në fund të shkurtit të vitit vijues për vitin pararendës, dhe publikimin e tyre në raportin e përbashkët. Kjo do të avancojë qasjen administrative të dhënave, sidomos në qeverisjen lokale, duke u mbështetur në faktin se deri më tani raportet mbi gjendjen e zgjidhjes së çështjeve administrative, kryesisht, nuk janë publikuar.

Fillimisht, Ligji mbi Procedimin Administrativ (LPA), të cilin Kuvendi e ka aprovuar në dhjetor të vitit 2016, është dashur të fillojë zbatimin në janar 2016, por ky afat inicial është shty tri herë, së pari më 1 korrik të vitit 2016, pastaj më 1 janar 2017, afati tjetër, i treti me radhë, 1 korrik 2017.

³³ / Ligji mbi Procedurën Administrative, "Gazeta zyrtare e Malit të Zi, nr. 056/14, 020/15

³⁴ / Analiza e efekteve të institucioneve të reja të Ligjit mbi Procedurën Administrative dhe LKA në Aplikimin dhe Procedurën e Gjykatës Administrative të Malit të Zi, Gjykata Administrative e Malit të Zi, UNDP, Podgoricë, Dhjetor 2015

Prolongimi trefishorë i shkaktuar nga shkalla e lartë e pamjaftueshmërisë së harmonizimit të rregullave të procedimit në ligjet e posaçme me LPA. Por, as gjatë vitit 2017, ky proces i harmonizimit nuk është rrumbullakosur në tërësi. Ministria e Administratës Publike në vitin 2016, dhe në fillim të vitit 2017, ka filluar harmonizimin e 90 ligjeve të resorëve të ndryshëm me LPA. Nga ky numër, 40 janë miratuar, katër muaj më pas para fillimit të Ligjit, 14 draft ligje janë aprovuar nga Qeveria, kurse 36 kanë qenë akoma në fazat e miratimit.³⁵

Rregullorja e harmonizimit të ligjeve të posaçme nuk ka përfunduar, Kuvendi i Malit të Zi, më 2 qershor 2017, ka votuar ndërrimet e Ligjit të Ri mbi Procedurën Administrative, për të përcaktuar se procedimet të cilët nuk kanë përfunduar të plotfuqishëm, deri në ditën e hyrjes në fuqi.

Të plotfuqishmit sipas ligjit të ri, përfundojnë me Ligjin e vjetër, edhe pse qëllimi paraprak ka qenë ndryshe. Në fakt, qëllimi ka qenë se veprimet e filluara sipas Ligjit të vjetër, të përfundojnë sipas Ligjit të ri, edhe në rast të zbatimit të plotë dhe dinjitoz të zgjedhjeve të reja, në masë të dukshme do të përshpejtoheshin rregullave të vjetra, në mënyrë që ligjvënësit në arsyetimin e ndryshimeve do ta thoshin vetë, ka shumë.³⁶

Disa nga ligjet themeltare, duke përfshirë edhe Ligjin e Inspektimit Mbikëqyrës, të cilin e definojnë mbikëqyrësi inspektues edhe ndërmarrjen e masave administrative, masat e tjera për largimin e padrejtësive në fushën e zbatimit të dispozitave, edhe nuk janë harmonizuar deri në mesin e qershorit 2017. Qeveria tre muaj më herët ka miratuar konkluzionin se Ministria e Ekonomisë dhe Drejtoria për punë inspektimi, sa më parë ta harmonizojnë këtë ligj.³⁷

SHËRBIME PËRMES RRUGËS ELEKTRONIKE: HAPAT E KONTESTEVE

Në momentet kur është përgatitur Strategjia për reformën e administratës publike, numri i serviseve në portalin e-administratës, i cili është pika unike e qasjes, përkatësisht “sporteli elektronik” për ofrimin e shërbimeve publike, ishte 77, ndërkaq në fillim të qershorit 2017 është shtuar në 215 servise në disponim.³⁸ Qëllimi është që deri në fund të vitit, të ekzistojnë 300 servise.³⁹

³⁵ / Informacion mbi përmbushjen e kërkesave për zbatimin e Ligjit të Ri mbi Procedurën Administrative, Podgoricë, mars 2017, të disponueshme në : http://www.gov.me/sjednice_vlade_2016/20

³⁶ / Jovanka Laliçiqi dhe Marta Shqëpanoviç, Propozimet për ndryshime në Ligjin për Procedurën Administrative, 31 maj 2017, <http://www.skupstina.me/zakoni/web/dokumenta/zakoni-i-drugi-akti/164/1441-9123-23-1-17-5.pdf>

³⁷ / Qeveria e Malit të Zi, nr. 07-883, Podgoricë, 13 prill 2017, http://www.gov.me/sjednice_vlade_2016/20

³⁸ / Intervistë me Milica Jankoviçin, Drejtore e Përgjithshme e Drejtorisë për Administrimin Elektronik dhe Sigurinë e IT-së të Ministrisë së Administratës Publike, mbajtur më 9 qershor 2017 në ambientet e Ministrisë së Administratës Publike.

³⁹ / Strategjia e Reformës së Administratës Publike në Mal të Zi 2016-2020, Qeveria e Malit të Zi, korrik 2016, e publikuar në: <http://media.mojauprava.me/2016/11/Strategjia-reforme-javne-uprave-u-Crnoj-Gori-2016-2020.godine.pdf>

Serviset elektronike radhiten sipas nivelit të shërbimeve, të cilët mund të ofrohen nëpërmjet portalit.⁴⁰ Mbi 40% të serviseve në portal e-administratës (82 gjithsej 192), të cilët kanë pasur qasje në fund të vitit 2016, kanë qenë të karakterit informativ, pra të nivelit 1 dhe 2 që kanë të bëjnë vetëm me ofrimin e informacioneve ose marrjen e formularëve.

Me shërbimet e tipit elektronik kuptohen serviset të cilët mundësojnë përfundimin e disa veprime nëpërmjet portalit, p.sh. plotësimi dhe dërgimi i formularit elektronik e në fund të vitit 2016 ka qenë e mundur të realizohen krahas e më shumë se gjysma e arritshme të serviseve (57%).

Rreth 215 servise kanë pasur qasje në portalin e-Administratës në qershor 2017. Qëllimi është që deri në fund të vitit të kenë qasje 300 servise. Në portal nuk ka shërbime që ofrojnë qeverisjet lokale.

Llojet e institucioneve që ofrojnë shërbime nëpërmjet portalit janë në nivel të ulët edhe dallohet edhe në Informatën që ka përgatitur Ministria e administratës publike në mars të vitit 2017: vetëm 30 institucione në fund të vitit 2016, i kanë bërë të disponueshëm nëpërmjet

portaleve, ndërkaq, në vitin 2015 numri i përgjithshëm i institucioneve të cilat kanë serviset e veta elektronike në portalin e-administratës, është shtuar vetëm 11%.⁴¹

Vetëqeverisjet lokale janë të "harruara" dhe kur kemi të bëjmë me portalin e-administratës, edhe pse Ligji mbi Administratën Elektronike është miratuar në vitin 2014 merret edhe me to.⁴² Në portal nuk është regjistruar asnjë vetëqeverisje lokale si ofruese shërbimesh. Derisa Ministria e Administratës Publike i ka marrë kompetencat e lëshimit të certifikatave digjitale për organet e administratës shtetërore komfor me ndryshimet e Ligjit mbi Nënshkrimin Elektronik dhe Identifikimin nga viti 2017, ajo edhe sot e kësaj dite nuk është kompetente për lëshimin e certifikatave vetëqeverisjeve lokale.⁴³ Ekziston synimi që deri në fund të vitit 2017, Ministria të marrë lëshimin e certifikatave vetëqeverisjeve lokale, që do të evitonte pengesat ekzistuese për publikimin e shërbimeve në porta.⁴⁴

⁴⁰ / Veçohen 5 nivele të dhënies së shërbimeve elektronike: Niveli i parë ka të bëjë me ofrimin e informacionet e domosdoshme, niveli i dytë mundëson marrjen e formularëve origjinale, niveli i 3 u bën të mundur shfrytëzuesve që në mënyrë elektronike të kërkojnë nëpërmjet portalit portal e-administratës, ndërkaq, niveli 4 u mundëson shfrytëzuesve përmes identifikimit të certifikatës digjitale, plotësimin interaktiv të formularit, dërgimin e dokumenteve shtesë-me fjalë të tjera, zbatimin e plotë të veprimt, grumbullimit të shtesave të duhura dhe përpunimi i plotë i lëndëve edhe shfrytëzuesi më në fund merr pa vajtje në organin e administratës shtetërore e merr në adresën e shtëpisë ose informacionin mbi lëndën e përfunduar.

⁴¹ / Qeveria e Malit të Zi, nr.07-883, Podgoricë, 13 prill 2017: http://www.gov.me/sjednice_vlade_2016/20

⁴² / Ligji mbi Administratën Elektronike, "Gazeta zyrtare e Malit të Zi", nr. 32/2014

⁴³ / Ligji mbi identifikimin elektronik dhe nënshkrimin elektronik, "Gazeta zyrtare e Malit të Zi", nr. 031/17

⁴⁴ / Intervistë me Milica Jankoviçin, Drejtore e Përgjithshme e Drejtorisë për Administrimin Elektronik dhe Sigurinë e IT-së të Ministrisë së Administratës Publike, mbajtur më 9 qershor 2017 në ambientet e Ministrisë së Administratës Publike



E-ADMINISTRATA PËR QYTETARËT: BARRIERAT

Sipas hulumtimeve të opinionit publik që i ka realizuar Agjencia IPSOS, **çdo i katërti qytetar deklaron se ka dëgjuar për portalin e-Administratës (27%), ndërsa një numër i vogël e ka shfrytëzuar (6%).** Qytetarët të cilët kanë pasur përvojë me administratën publike të shumtën janë të njoftuar (30%) edhe e kanë shfrytëzuar portalin (13%). Qeveria po ashtu e ka parë nivelin e ulët të njohurive të shfrytëzuesve në fushën e veprimtarisë elektronike, përkatësisht të

mungesës së diturisë informatike, si dhe pa informimin e shfrytëzuesve mbi ekzistimin e e-shërbimeve në portalin e e-administratës, si njërin ndër faktorët që ndikojnë negativisht në përpjekjet e kësaj lënde.⁴⁵

Përveç mosinformimit dhe çmimit, relativisht të lartë të certifikatës digjitale, i cili është parakusht i identifikimit me rastin e shfrytëzimit të shërbimeve të avancuara, paraqet pengesën shtesë. Sipas çmimoreve të Postës së Malit të Zi, e cila është kompetente t'ua lëshojë certifikatën qytetarëve, çmimi i certifikatës digjitale për nënshkrimin e avancuar, nëpërmjet të cilit me saktësi garantohej identiteti i nënshkruesit dhe integriteti i dokumentit elektronik, kushton deri në 110 euro.⁴⁶

⁴⁵ / Informacion mbi portalin e e-Administratës për vitin 2016, Qeveria e Malit të Zi, Ministria e Administratës Publike, mars 2017

⁴⁶ / Listë çmimi për lëshimin dhe rinovimin e një certifikate dixhitale të kualifikuar, Posta e Malit të Zi

ZHVILLIMI DHE KOORDINIMI I POLITIKAVE PUBLIKE

Në fushën e koordinimit të politikave publike, sidomos jemi fokusuar në informimin e qytetarëve mbi shqyrtimet publike, pengesat procedurale për pjesëmarrje efikase të opinionit në marrjen e vendimeve dhe të koordinimit mes nivelit qendror dhe atij lokal.

Si studim të posaçëm të rastit, kemi analizuar shqyrtimet publike mbi Draft vendimet lidhur me buxhetin e qeverisjeve lokale, që ofron një pasqyrë të rëndësishme në këtë tematikë, duke marrë parasysh se në nivelin qendror, ekziston ndalimi i zbatimit në nivelin qendror të diskutimit publik mbi Ligjin e buxhetit shtetëror.

Vetëm 4 % të qytetarëve janë shumë të interesuar mbi diskutimet publike, të cilët organizohen me rastin e miratimit të dispozitave dhe dokumenteve strategjike. Informimi i ulët ndikon edhe në pjesëmarrjen e vogël të qytetarëve në shqyrtimet publike, fjala vjen, në diskutimin publik mbi Draft buxhetin e Kryeqytetit, Podgoricës, asnjë qytetar individualisht nuk ka marrë pjesë.

Sidomos është shqetësues fakti se gjatë vitit 2017, janë shmangur shqyrtimet publike lidhur me ndryshimet e rëndësishme, duke përfshirë edhe ndryshimet e Ligjit të Prokurimeve Publike, ligjit kyç, i cili rregullon shpenzimin e të hollave publike, dhe ndryshimet e Ligjit mbi Qasjen e Lirë në Informata, nga i cili në masë të madhe varet transparenca e administratës sonë.

Analiza e ndikimit e dispozitave, edhe më tej nuk ka qasje krahas Draft ligjit i cili jepet në diskutim publik.

Ka arritur të ndryshimet organizative në aspektin e kompetencës ndaj koordinimit të politikave publike, meqë pjesërisht janë zhvendosur nga Sekretariati i Përgjithshëm i Qeverisë në Ministrinë e Re të Punëve Evropiane. Këto ndryshime organizative në të shumtën sqarojnë ngadalësimin lidhur me realizimin e masave të avancimit të koordinimeve të politikave publike, të definuar të përcaktuara me Strategji.

NDARJET E REJA TË PUNËVE KOORDINUESE TË POLITIKAVE PUBLIKE

Me dekretin e ri të organizimit dhe mënyrës e punës së administratës shtetërore, është themeluar Ministria e Punëve Evropiane, në kompetencat e së cilës i janë besuar, ndër të tjera, vendosja edhe zhvillimi i sistemi i koordinimit të përcjelljes së harmonizimit të dokumenteve strategjike me të cilët përcaktohet politikat publike, bashkëpunimi dhe koordinimi me organet shtetërore lidhur me planifikimin strategjikë në politikat publike, vlerësimi i arritjes dhe përcjelljes së shkallës së jetësimi të dokumenteve strategjike, me të cilat përcaktohen politikat publike.⁴⁷ Me këtë koordinimi i politikave publike në një

⁴⁷ / organizimin dhe mënyrën e punës së administratës shtetërore, "Gazeta zyrtare e Malit të Zi", nr. 005/12, 025/12, 044/12, 061/12, 020/13, 017/14, 006/15, 080/15, 035/16, 041/16, 061/16, 073/16, 003/17, 019/17

pjesë është përjashtuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Qeverisë, që reflektohet edhe në organizimin e brendshëm të këtyre organeve.⁴⁸

Me këtë është inkorporuar edhe risia e rëndësishme së organizimit të administratës shtetërore, disa muaj pas miratimit të Strategjisë së Reformës të Administratës Publike në korrik 2017. Vonesa e realizimit të masave që kanë të bëjnë me zhvillimin dhe të koordinimit të politikave publike, në një masë të madhe është kushtëzuar me këtë organizim të ndryshimeve, duke u mbështetur në faktin se është bartës i aktiviteteve kyçe në këtë fushë, siç është metodologjia e mënyrës së planifikimit dhe vlerësimi i arritjeve të politikave së Ministrisë së porsa themeluar.

Megjithatë, arsyetimi i këtyre ndryshimeve, të cilat janë shfaqur në nivelin e ndryshimeve të reja të Strategjisë, ka ngecur edhe pasqyruar në analizat mbi koordinimet e deritashme të bashkërenditjes së politikave publike në Malin e Zi.

NJË HAP PAS NË KONSULTIMIN E OPINIONIT TË INTERESUAR

Gjatë vitit 2016 dhe 2017 është aprovuar edhe propozuar një numër ligjesh, të cilët kanë vazhduar trendin vetëm të kyçjes formale të opinionit të interesuar mbi zhvillimin e politikave publike, krahas mungesës së analizave mbi të cilat zhvillimi dhe koordinimi i politikave publike do të mbështeteshin.

Në anën tjetër, sidomos gjatë vitit 2017, janë regjistruar trende negative shitesë të tejkalimit të shqyrtimeve publike me rastin e sjelljes së dispozitave të rëndësishme (ndryshimet e Ligjit mbi Prokurimet Publike)⁴⁹, vetëm të organizimit të përsëritshëm të diskutimeve publike (ndryshimet e Ligjit mbi Qasjen e Lirë të Informacioneve)⁵⁰, të organizimit të shqyrtimeve "sipas procedurës së shkurtuar" (ndryshimet e Ligjit mbi Mbrojtjen Sociale dhe Mbrojtjen e Fëmijëve⁵¹) dhe organizimin e konsultimeve publike në vend të diskutimeve publike (tetë ligje nga fusha e arsimit).⁵²

48 / Rregulloret mbi organizimin e brendshëm të punës të këtyre organeve, parashihet nga 9 nëpunës mbi koordinimin e politikave publike; Sektori për Koordinim dhe Monitorim të realizimit të politikave të Qeverisë, në Sekretariatit e Përgjithshëm në përgjithësi do të fokusohen në koordinimin dhe hartimin e programit të Qeverisë, si dhe në realizimin konkluzioneve dhe mbështetjen e Këshillit të Privatizimit.

49 / Shih: Fshehurazi mbi Prokurimet Publike: Ndryshimet kontestuese zmrapsin sistemin, Instituti Alternativa, më 23.05.2017: <http://institut-alternativa.org/tajno-o-javnim-nabavkama-sporne-izmjene-unazaduju-sistem/>

50 / Me rëndësi të posaçme është kreu i propozuesit, qoftë se Ligji ndryshohet vetëm në pjesën që ka të bëjë me përdorimin e serishëm të informacioneve, për çka shqyrtimi publik ka qenë i përqendruar vetëm lidhur me pyetjen për qasjen në informacione.

51 / Shih: Ndryshimet e Ligjit mbi Mbrojtjen Sociale dhe të Fëmijëve, përjashtimin e opinionit me arsyetimin e procedurës urgjente, Instituti Alternativa, më 06.06.2017: <http://institut-alternativa.org/izmjene-zakona-o-socjalnoj-i-djecjoj-zastiti-iskljucivanje-javnosti-pod-izgovorom-hitnog-postupka/>

52 / "Apel opinionit profesional dhe laik për pjesëmarrje në diskutimin publik mbi tekstet e draft ligjit" nga fusha e arsimit, të botuar në faqen e Ministrisë së Arsimit, më 20 prill edhe ka zgjatur deri më 10 maj, pra 20 ditë, që është afati i përcaktuar për organizimin e konsultimeve publike, që komfor Dekretit mbi Veprimin dhe Mënyrën e realizimit të shqyrtimit publik, lidhur me përgatitjen e ligjit (Gazeta zyrtare e Malit të Zi, nr. 012/12) që zbatohen para jetësimit të diskutimeve publike, në një afat së paku, 20 ditë, kurse shqyrtimet publike realizohen në një kohëzgjatje së paku 40 ditë.

Asnjëri nga ligjet e lartshënuara, në rastet e nxjerrë në diskutim publik, nuk ka pasur analizë mbi ndikimin e dispozitave, edhe pse Strategjia mbi Reformën e Administratës Publike e ka parë nevojën që këto analiza të jepen në shqyrtim publik me draftin. Me këtë qytetarët do të njiheshin më mirë me mundësitë e pasojave të politikave publike edhe do të dispononin me kapacitetet e pjesëmarrjes në zhvillimin e tyre.

SHQYRTIMI PUBLIK PA OPINION: RASTI I BUXHETEVE LOKALE

Sipas hulumtimeve të opinionit publik, të cilin për nevojat e Institutit Alternativa e ka realizuar Agjencia IPSOS, **qytetarët në numër të madh nuk janë të informuar mbi diskutimin publik, të cilin e organizojnë organet e administratës publike (58%), deri në një masë janë të informuar 38% të qytetarëve, ndërkaq një numër shumë i vogël është i informuar mirë (4%).** Nga radhët e qytetarëve, të cilët pohojnë se janë të informuar mbi diskutimet publike (gjithsej 42%), një numër i vogël ka marrë pjesë në to – gjithsej 3%.

Vetëm 3% të qytetarëve kanë marrë pjesë në diskutimet publike sipas sondazheve të opinionit publik

Analiza e raporteve dhe e shqyrtimeve publike mbi vendimet e buxhetit në nivelin lokal, po ashtu konfirmojnë pjesëmarrje të vogël të opinionit të interesuar. Një mangësi e madhe e cila bën të pamundur

vlerësimin adekuat të organizimit të diskutimeve publike, është edhe raporti jo preciz mbi shqyrtimet publike në kontekstin e prezantimit të numrit dhe të strukturës së pjesëmarrësve.

Nga 19 raporte mbi diskutimet publike lidhur me propozim buxhetin për vitin 2017, që IA i ka marrë mbi bazat e kërkesave për qasje të lirë të informacioneve, 13 prej tyre nuk i kanë të dhënat e hollësishme mbi numrin e pjesëmarrësve në shqyrtimin publik. Nuk apostrofohet numri i pjesëmarrësve, ose përdoren formulime të tipit të papërcaktuar “disa qytetarë”. Në komunat Shavnik, Pluzhinë Kryeqytet-Podgoricë, nuk ka pasur fare pjesëmarrës **“nga radhët e qytetarëve në shqyrtimet publike mbi propozim buxhetin për vitin 2017”**.

Nëse krahasojmë tri komunat, të cilat kanë raportuar saktë mbi strukturën e pjesëmarrësve në diskutimet publike mbi propozim buxhetet për vitin 2017, këto janë: Nikshiqi, Ulqini, Zhablaku, interesimi më i madh i tyre ka qenë se si do të shpenzohen mjetet e tyre financiare sivjet rreth 60 qytetarë të pranishëm në të gjitha diskutimet publike. Ky numër kaq i madh i qytetarëve është rezultat i tre diskutimeve publike në lokalitete të ndryshme, përkatësisht në bashkësi të ndryshme vendore. Në Nikshiq “rreth 20 qytetarë të interesuar” kanë marrë pjesë në diskutimin publik, kurse në Zhablak një numër shumë i vogël, vetëm dy qytetarë të pranishëm.

ZHVILLIMI I POLITIKAVE KRAHAS INJORIMIT TË ARGUMENTEVE: SHEMBULLI I DY LIGJEVE

Mbi bazat e dy shembujve të procesit të hartimit të ligjeve gjatë vitit 2016 dhe 2017, që rregullojnë numrin e çështjeve me rëndësi publike (Ligji mbi të Ardhurat e të Punësuarve në Sektorin Publik, Ligji mbi Rregullimin Hapësinorë dhe të Ndërtimit të Objekteve, përkatësisht të planifikimit dhe ndërtimit), tregojnë mangësitë sistematike në fushën e ndërtimit dhe të koordinimit të politikave, sidomos mes nivelit qendror dhe lokal.

Të dy rastet, një numër i konsiderueshëm i komenteve nga shqyrtimet publike nuk është përfillur, as përpunuesi në hollësi ka raportuar mbi rrjedhat e diskutimit publik dhe mbi të gjithë komentet e arritura. Janë dallime të shumta midis Draftit dhe më vonë të Propozim Ligjit të aprovuar, që nuk kanë bazë në diskutimin publik as në argumentet e propozuesit. Po ashtu, për të dy draftet është karakteristike se Analiza e ndikimit të dispozitave nuk ka qenë në disponim gjatë shqyrtimit publik.

a) Ligji mbi Rregullimin Hapësinor dhe Ndërtimin e Objekteve ose Ligji i Planifikimit dhe Ndërtimit?

Në nëntor të vitit 2015, Ministria e Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe Turizmit ka nxjerrë në diskutim publik **Propozim Ligjin mbi Rregullimin Hapësinor dhe Ndërtim të Objekteve**. Po ashtu edhe vetëqeverisjeve lokale u ka dërguar Draftin, mbi të cilin 11 vetëqeverisje vendore kanë dhënë sugjerimet dhe mendimet e tyre.⁵³

Drafti ka parashikuar që lejen e ndërtimit ta lëshojë **organi i vetëqeverisjes lokale**,⁵⁴ kurse organi i administratës do të kishte në kompetencë lëshimin e lejeve në rastin e objekteve shtetërore me interes të përgjithshëm dhe të tjerë.⁵⁵ Me rastin e këtyre zgjidhjeve, Bashkësia e komunave e Malit të Zi ka propozuar që procedura e lëshimit të lejes së ndërtimit ta transferojë në nivelin shtetëror në rastet kur disa qeverisje vendore lëshojnë të ngjashmet në kundërshti me ligjin me qëllim të valorizimit të hapësirës dhe uljen e barrierave të biznesit.⁵⁶ Qëndrimi i Ministrisë me rastin e këtij komenti ka qenë se zgjidhja softwer për lëshimin e lejeve të detyrojë organet shtetërore dhe lokale të veprojnë njësoj.

⁵³ / Përgjigjet në kërkesat e Institutit Alternativa për Qasje të Lirë në Informacione dërguar vetëqeverisjeve lokale, mars 2017.

⁵⁴ / Vetëqeverisja lokale do të duhej, sipas atij vendimi, të lëshojë lejen e ndërtimit në bazë të projektit kryesor me raport mbi revizionin e bërë dhe dëshmitë mbi sigurinë nga përgjegjësia e shoqërisë ekonomike, personit juridik, përkatësisht ndërmarrësit (në vazhdim: shoqëria ekonomike), e cila ka hartuar projektin kryesor dhe të shoqërisë ekonomike që ka reviduar projektin kryesor, komfor ligjit.

⁵⁵ / Draftligji mbi Rregullimin Hapësinor dhe Ndërtimin e Objekteve, i disponueshëm në:

http://www.mrt.gov.me/rubrike/javna_rasprava/154804/Nacrt-zakona-o-uredenju-prostora-i-izgradnji-objekata.html

⁵⁶ / Raporti mbi diskutimin publik rreth Draftligjit të Rregullimit Hapësinor dhe Ndërtimit të Objekteve, Ministria e Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe Turizmit, më 26. 09.2016, f. 126, i disponueshëm në:

http://www.mrt.gov.me/rubrike/javna_rasprava/165311/Izvjestaj-o-javnoj-raspravi-o-Nacrtu-zakona-o-uredenju-prostora-i-izgradnji-objekata.html

Çelebiq SHPK, ka propozuar mundësinë e lëshimit të lejes së ndërtimit vetëm komfor **zgjidhjes ideore**, të lëshuar nga urbanisti mbi bazat e të cilit do të realizoheshin punët përgatitore.⁵⁷ Por, as ky koment nuk është miratuar me arsyetimin se punët përgatitore mund të zbatohen vetëm mbi bazat e projektit kryesor.

Një vit e më shumë më vonë, Ministria në fillim të muajit prill të vitit 2017, ka mbajtur një konferencë në të cilën është prezantuar **Ligji mbi Planifikimin dhe Ndërtimin**, atëherë në formën e tashmë të aprovuar të Draftit edhe me emër të ri. Ndër të tjera, vetëqeverisjeve vendore, pa deklarin e tyre, më vonë u është marrë kompetenca për lëshimin e lejeve të ndërtimit. Në fakt, leja e ndërtimit plotësisht është hequr edhe është zëvendësuar me monitorimin e inspektoratit të dokumentit që dorëzon investuesi.

Ministria, nën presionin e opinionit, sërish ka organizuar shqyrtim publik rreth Propozim ligjit mbi planifikimin dhe ndërtimin.⁵⁸ Shumica e komenteve është refuzuar pa arsye.

Ecuria e përgatitjeve të këtij ligji është dëshmi e planifikimit të dobët dhe papërgjegjësisë ndaj personave me invaliditet dhe personave me aftësi të kufizuara, meqë afatet qasjes pa pengesë të objekteve në përdorim publik te këtyre personave janë prolonguar karshi arsyetimeve të mëparshme edhe pa analiza mbi avancimin e deritashëm.

Drafti i parë (Ligji mbi Rregullimin Hapësinor dhe Ndërtimin e Objekteve) ka përcaktuar se pronari i objektit në përdorim publik personave me invaliditet dhe personave me aftësi të kufizuara, t'u sigurojë qasje pa pengesa deri në gjysmën e vitit 2016, ndërsa për qëndrim dhe lëvizje deri në **vitin 2017**.

Në raportin nga shqyrtimi i parë, Ministria ka marrë vendim që afati për adaptimin e objekteve personave me invaliditet dhe personave me aftësi të kufizuara, të fshihet, meqë



⁵⁷ / Njëjtë.

⁵⁸ / Shqyrtimi publik mbi Draftligjin e Planifikimit dhe Ndërtimit, 04.05.2017, Ministria e Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe Turizmit, i disponueshëm në: http://www.mrt.gov.me/rubrike/javna_rasprava/171902/Javna-rasprava-o-Nacrtu-zakona-o-planiranju-i-izgradnji.html

më herët i ka prolonguar afatet të përcaktuara atëherë me ligjin në fuqi. Drafti i ri, megjithatë ka parashikuar afate: qasje objekteve do të duhej të sigurohet deri në vitin 2019, ndërsa për lëvizje deri më 2021, me kusht që Ligji të miratohet gjatë vitit 2017.⁵⁹ Ky prolongim i afateve, ka qenë posaçërisht, objekt kritike i Shoqatës së të rinjve handicap të Malit të Zi⁶⁰, duke pasur parasysh faktin se Ligji në fuqi mbi Rregullimin Hapësinor dhe ndërtimin e objekteve që në vitin 2008, ka parashikuar një afat 5- vjeçar për adaptimin e objekteve në përdorim publik për qasje dhe shfrytëzim, i cili as deri në vitin 2013 nuk është përfillur.

b) Ligji mbi të Punësuarit në Sektorin Publik

Ligji mbi Pagat e të Punësuarve në Sektorin Publik është miratuar në marsin e vitit 2016, me qëllim që të gjithë të punësuarit në sektorin publik t'i përfshijë sistemi unik i llogaritjes së të ardhurave edhe në këtë mënyrë të korigjojë mospërputhjet ekzistuese. Miratimit të tij i ka parapri diskutimi publik, gjatë së cilit një numër i konsiderueshëm i palëve të interesuara ka pasur vërejtje serioze.⁶¹ Vërejtjet më serioze gjatë diskutimit publik i janë shtruar vetëqeverisjeve lokale – në mënyrë të pavarur ose përmes Bashkësisë së Komunave të Malit të Zi. Në fakt, disa raste i kanë tërhequr vërejtjen Ministrisë së Financave se dispozitat e Ligjit nuk janë në harmoni me Kartën Evropiane mbi vetëqeverisjen vendore, se do të humbas autonomia financiare e qeverisjeve lokale, si dhe një numër i konsiderueshëm i titullarësh të nivelit lokal nuk është përfshi me Draftligjin.⁶²

Vërejtjet më të mëdha të vetëqeverisjeve lokale kanë qenë se Drafti dukshëm ngrit pagat e personave udhëheqës në krahasim me nëpunësit, si dhe vërejtja se nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare për pagat e të punësuarve.

Bashkësia e komunave të Malit të Zi gjatë shqyrtimit publik ka kërkuar që të përcaktohen kushtet e njëjta për zvogëlimin dhe ngritjen e mjeteve për pagat në nivel shtetëror dhe atë lokal, meqë Drafti ka parashikuar kushtet e uljes së pagave vetëm në nivelin lokal.⁶³ Megjithatë, qëndrimi i Ministrisë ka qenë, që pikërisht, qeverisjet lokale gjatë periudhës së kaluar nuk i kanë servirur rregullisht detyrimet e veta që pretendohet të zgjidhet me këtë ligj, sanksione në aspektin e uljes së pagave.

⁵⁹ / Përcaktimit të Draftligjit i ka parapri aktiviteti i grupit punues gjatë së cilit përfaqësuesit e organizatave joqeveritare gjatë punës kanë thënë se Drafti i ri nuk do të ketë afate të reja për adaptimin e objekteve, ky informacion është marrë përmes fokus grupit të OJQ- ve, të mbajtur më 10 maj 2017, në zyrat e Institutit Alternativa.

⁶⁰ / Fokus grupi me përfaqësuesit e Sektorit Joqeveritar, mbajtur më 10 maj 2017, në zyrat e Institutit Alternativa.

⁶¹ / Organizatat joqeveritare, vetëqeverisjet lokale, agjencitë e pavarura dhe rregullatorë, shoqatat profesionale, partitë politike, sindikata.

⁶² / Raporti i shqyrtimit publik mbi Draftligjin e Pagave të të Punësuarve në Sektorin Publik, i disponueshëm në: http://www.gov.me/sjednice_vlade/134

⁶³ / Njëjtë.

Informacioni mbi çështjen e zbatimit të Ligjit është aprovuar vetëm katër muaj pas fillimit të jetësimit, ka konfirmuar lëshimet në aspektin e aprovimit dhe koordinimit të pamjaftueshëm, meqë gjysma e komunave nuk kanë pasur mundësi për të zbatuar dispozitat e reja.⁶⁴

Në nëntor të vitit 2016, rebalanci për vitin vijues është miratuar me procedurë të shkurtuar ndër të tjera për shkak të shpenzimeve shtesë për pagat që ka sjellë zbatimi i Ligjit.⁶⁵

Një vlerësim i dobët i ndikimit fiskal, por edhe mungesa e të nuhaturit për komentet e shqyrtimit publik ka kushtëzuar një kosto të lartë për qytetarët e Malit të Zi: Analiza e vlerësimeve të ndikimit të dispozitave ka parashikuar rritjen e shpenzimeve në shumën prej 9 milionë eurosh, derisa me rebalanc, të ardhurat bruto janë ngritur 19 milionë euro shtesë.⁶⁶

Ligji mbi Pagat e të Punësuarve në Sektorin Publik është ndryshuar me nismën e Qeverisë vetëm 9 muaj pas aprovimit, me procedurë të shkurtuar, duke apostrofuar se nevoja për ndryshimet pas nevojës së konsolidimit fiskal.⁶⁷

Ligji është ndryshuar për faktin se funksionet shtesë me koeficientet që i kanë munguar Ligjit, si dhe dispozitat mbi mundësinë për vetëqeverisjet lokale për të përcaktuar koeficiente më të ulëta, në rastin se nuk janë në mundësi për të siguruar mjete për paga të punësuarve, ndonëse gjatë diskutimit publik rreth të dy çështjeve është tërhequr vërejtja.

⁶⁴ / Një komunë nuk ka miratuar vendimin mbi harmonizimin e koeficientit komfor ligjit, ndërsa katër nuk kanë marrë përkrahje të vendimit për shkak të mospërfilljes së instruksioneve të Ministrisë së Financave mbi hartimin e këtij akti, ndërsa katër komuna e kanë njoftuar Ministrinë e Financave se nuk kanë mundësi që të zbatojnë Ligjin për shkak të mungesës së mjeteve. Shih: Informata mbi zbatimin e Ligjit të Pagave të të Punësuarve në Sektorin Publik, Qeveria e Malit të Zi, seanca 167, pika 4, në disponim: http://www.gov.me/sjednice_vlade/167

⁶⁵ / Rebalanci i Buxhetit – çfarë ka ndodhur, kush është vërtet përgjegjës?, Instituti Alternativa, të disponueshme në: <http://institut-alternativa.org/rebalans-budzeta-sta-se-zapravo-desilo-i-ko-je-odgovoran/>

⁶⁶ / Njëjtë.

⁶⁷ / Mendimi i Ministrisë së Financave rreth Propozim Ligjit mbi Plotësimin e Ligjit mbi Pagat e të Punësuarve në Sektorin Publik, f.20 të disponueshme në: <http://www.skupstina.me/zakoni/web/dokumenta/zakoni-i-drugi-akti/70/1345-8483-33-16-8.pdf>

SISTEMI ZYRTAR DHE MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE

Problemi kyç në marrëdhëniet administrative dhe drejtimin e resurseve njerëzore, është “trashëguar” nga periudha pararendëse, kanë vazhduar ta rëndojnë administratën edhe gjatë vitit 2016 dhe 2017, edhe pse pritet miratimi i Ligjit mbi Nëpunësit dhe Funkionarët Shtetërorë, që do të duhej të përgjigjet në disa probleme në këtë fushë.

Perceptimi i qytetarëve mbi punësimin në administratën publike është shumë negativ: më shumë se një e pesta konsideron se “punësimi nëpërmjet lidhjeve”, është problemi më i madh i administratës sonë.

Në mostrën e organeve shtetërore, të cilën e kemi përzgjedhur për nevojat e këtij raporti, edhe sot e kësaj dite vërehet konkurrenca e ulët e plotësimit të vendeve të punës: më shumë se në 40% të rasteve, janë përzgjedhur nëpunësit të cilët kanë qenë kandidatët e vetëm për vendet përkatëse të punës. Në rrethanat e këtilla të ulëta të konkurrencës, të shumtën është përzgjedhur kandidati i renditur i pari. Në një rast, në Dikasterin e Prokurimeve Publike, në bazë të intervistës me drejtorin, duke zbatuar autorizimin e diskrecionit, është përzgjedhur kandidati i renditur i dyti.

Në katër të përzgjedhurit e 10 organeve shtetërore, janë shënuar lidhje të kontratave të punës, të cilët do të duhej të ishin në përshkrimin e punës të nëpunësve të punësuarve. Kjo do të thotë se kontratat janë nënshkruar në kundërshtim me Ligjin.

Vakumet juridike në fushën e drejtimit të resurseve njerëzore në nivelin lokal pengojnë punësimin e mbështetur në merita dhe racionalizimin e administratave lokale. Vlerësimi i punës, sidomos në nivelin shtetëror, është larg nga vlerësimi i efektit të të punësuarve. Edhe më tej ekzistojnë organet në të cilat të gjithë nëpunësit janë të shkëlqyeshëm, siç është në Agjencitë e Mbrojtjes së Mjedisit.

AKTIVITETI NORMATIV

Gjatë vitit 2016 dhe 2017 është punuar për ndryshimin e Ligjit mbi Nëpunësit Shtetëror, përkatësisht në përpunimin e Ligjit të ri. Ndryshimi i kornizës ligjore është filluar që në vitin 2015, për shkak të nevojave të avancimit të dispozitave që kanë të bëjnë me punësim edhe përzgjedhjen e kandidatëve, vlerësimin dhe avancimin edhe të kuadrit të lartë udhëheqës.

Në qershor të vitit 2017 është përcaktuar Propozimi i ndryshimeve të ligjit të ri mbi qeverisjen lokale, me qëllim, ndër të tjera, në mënyrë që më afër të rregullohen marrëdhëniet e nëpunësisë, duke marrë parasysh hapësirat e mëdha juridike, të cilat kanë ekzistuar në këtë fushë sa i përket komunave në Mal të Zi. Në të vërtetë, Ligji ekzistues mbi qeverisjen lokale nuk e rregullon fare më afër sistemimin e punësimin, por të udhëzon në zbatimin e Ligjit mbi Nëpunësit edhe Funkionarët Shtetërorë.

68 / Vendimi mbi ngritjen e grupit ndër resor për përgatitjen e Propozim ligjit mbi ndërrimet dhe plotësimet e Ligjit mbi Nëpunësit dhe Funkionarët Shtetërorë, Qeveria e Malit të Zi, Ministria e Punëve të Brendshme, Vendimi nr.1-050/15-50350/1, Podgoricë, më 28.07.2015.

Mendimi i qytetareve dëshmon se kjo fushë do të duhej të jetë njëra nga përparësitë e Reformës së Administratës Publike. Në fakt, si njërin ndër problemet më të mëdha të administratës publike qytetarët fokusojnë punësimin „përmes lidhjeve“. Çdo i dyti qytetar konsideron se ky është njëri ndër problemet (51%), ndërsa çdo i pesti është problemi më i madh (22%). Punësimi „përmes lidhjes“ si problem shpesh apostrofohet në rajonin e veriut (34%), në zonat rurale (31%), sidomos u pengon të papunësuarve (33%).

Ndërkohë, zbatimi i Ligjit mbi Nëpunësit Shtetërorë nga viti 2013, dispozitat e të cilit zbatohen edhe në nivelin lokal, ka vazhduar krahas problemeve të pazgjidhura, të cilat IA i ka hetuar në raportet e veta të mëhershme. Ndër të tjera, dallimi mes numrit relativisht të vogël të kandidatëve për vende të punës në organet shtetërore dhe të interpretimit të gjerë të të drejtave të diskrecionit të eprorëve që të bëjnë zgjedhjen në mes 5 kandidatëve më të mirë të vlerësuar, edhe më tej është i pranishëm.

Me aprovimin e Ligjit mbi Pagat e të Punësuarve në Sektorin Publik, në mars të vitit 2016 është inkorporuar sistemi i ri i pagave edhe është suprimuar sistemi i përpunuar edhe me ketë e vetmja bazë është avancimin automatik (në kategorinë më të lartë të pagesave) për nëpunësit shtetërorë. Zbatimi i Ligjit ka hasur në problemet e përshkruara më parë në praktikë, (Shih: Kaptinë mbi Zhvillimin dhe Koordinimin e Politikave Publike).

Që ta shfaqim një vështrim më të hollësishëm në sfidat kyçe të drejtimit të resurseve njerëzore në administratën publike, nga 9 organe shtetërore dhe 4 qeverisje lokale kemi kërkuar informacione kyçe të cilat kanë të bëjnë me procedurën e zgjedhjes së nëpunësve dhe funksionarëve, sistematizimin e tyre, ankesat, zbatimi i institutit të kontratës mbi punën, kontratën mbi punët e përkohshme.

PROBLEMET E VJETRA NË NIVEL SHTETËROR

Kur është fjala për organet shtetërore, kemi përfshirë Sekretariatën për Zhvillimin e Projekteve, Mbrojtësin e Interesave Pronësore-Juridike, Agjencinë për Mbrojtjen e Mjedisit, Ministrinë e Financave, Drejtorinë për Prokurime Publike, Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Ministrinë e Sportit.

Duke shikuar dokumentacionin e punësimit, janë konfirmuar gjetjet e mëparshme të IA në këtë fushë: mesatarisht, numri i kandidatëve që kalojnë testimin sipas kandidatëve të zgjedhur është 2,1 %, që përveç atyre faktike, konkurrenca e ulët, nuk shkon në favor as zgjedhjes ekzistuese që eprori i organit ka diskrecion. Me rastin e zgjedhjes së nëpunësit apo funksionarit nga lista për zgjedhje të cilën e përbëjnë 5 kandidatët e parë të renditur.

69 / Raporti mbikëqyrës: Punësimi dhe Avancimi në Organet Shtetërore për vitin 2014, Instituti Alternativa Podgoricë, maj 2017, është në disponim: <http://institut-alternativa.org/monitoring-izvjestaj-zaposljavanje-i-napredovanje-u-drzavnim-organima-u-2014-godini/>

70 / Komuna e Plevles, Ulqinit, Kollashinit, dhe Podgorica.

Kjo e dhënë po ashtu nuk përfill as qëllimin, përmbajtjen në Strategjinë për Reformën e Administratës Publike, që autorizimet e diskrecionit të eprorit në rastin e punësimit sjell zvogëlimin e listës për zgjedhje, nga 5 në 3 kandidatë pa masa shtesë të cilat do të qartësojnë gjendjen në të cilat e drejta e diskrecionit mund të shfrytëzohet.

Duhet pasur parasysh se të dhënat e prezantuara, duke përfshirë edhe tipat e ndryshme të shpalljeve: publike edhe interne (ndër organe apo brenda), për çfarë është depozituar dokumentacioni, kryesisht ka të bëjë me shpalljet publike (36) ndërkaq në një masë më të vogël në shpalljet interne brenda organeve (8) dhe mes organeve (3).

Sipas raportit të Administratës për Kuadro, numri mesatar i kandidatëve të paraqitur në shpalljet publike gjatë vitit 2016 është 5.66, në ato interne mes organeve shtetërore 0.52 dhe në shpalljet interne brenda organeve shtetërore 0.53.

Për shkak të konkurrencës së vogël, ekzistojnë pretendime që të suprimohet shpallja interne që do të çelte hapësirë për avancim në shumë profesione për nëpunës të cilët i plotësojnë kushtet. Megjithatë, edhe përballë rritjes së numrit të kandidatëve të aplikuar, nuk krijohen kushtet e punësimit të mbështetur mbi meritat, nëse nuk bëhet kufizim shtesë i shfrytëzimit të autorizimeve të diskrecionit të eprorit të organit, që ka të bëjë me konfirmimin e aftësive të përpunuara. Imponohet edhe si një nivel i vendimmarrjes politike me rastin e zgjedhjes së nëpunësve. Në fakt, pas procedurës së konfirmimit të aftësive, eprori mund të vendosë për të realizuar intervistën me gojë më kandidatë nga lista për zgjedhjen, që janë 5 kandidatët e renditur më të mirë, edhe të vendos për të zgjedhur kandidatin tjetër.

Tabela nr. 1: Pasqyra e vendimeve të përzgjedhjes të përfshirë në organet shtetërore; burimi: përgjigjet në kërkesat e qasjes së lirë informacioneve, faqes së internetit të Administratës për Kuadro

Institucioni	Numri i vendimeve të zgjedhjeve	Kandidati i vetëm	I renditur i pari	I renditur i dytë /tjerët sipas radhës në listë për zgjedhje	Numri i kandidatëve që vërtetuan aftësitë
Administrata për Prokurime Publike	2		1	1	8
Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit	1	1			1
Mbrojtësi i Interesave Pron.-Jur.	4	2	1	1	12
Sekretariati për Projektet Zhvillimore	4	3	1		5
MPB	92	28	35	29	211
Komisioni për Koncesione					
Administrata e Pronës					
Ministria e Financave	32	19	12	1	53
Ministria e Sportit					
Gjithsej:	135	53	50	32	290

Tabela nr.1 tregon numrin e gjendjes në rastet e analizuara, në të cilat nuk është zgjedhur kandidati i renditur i pari. Ndërkaq, në rastet kur janë përzgjedhur edhe kandidatët tjerë nga lista, kjo ka ndodhur sepse me shpallje janë kërkuar më shumë persona për një vend pune ose kandidati i parë i renditur është zgjedhur në një vend tjetër.

Vetëm në një rast, në Administratën për Kuadro, mbi bazat e intervistës me drejtorin duke zbatuar autorizimin e diskrecionit, është përzgjedhur kandidatja e renditur e dyta. Pas konfirmimit të aftësive në të cilin nuk ka qenë e vlerësuar më e mira. Arsyetimi i dhënë, nuk është në pajtueshmëri me vërtetimin e aftësive, e cila duhet të jetë pikërisht në konfirmimin e cilësive profesionale dhe të punës, siç janë njohja e sistemit të prokurimeve publike dhe motivacioneve, të cilat eprorin e kanë orientuar, që përballë faktit se nuk ka qenë në listë e para, të bëjë përzgjedhjen e kandidates së renditur e dyta.

Ministria e Sportit nuk i ka dorëzuar vendimet mbi përzgjedhjet sepse nuk i posedon, por vetëm shtatë vendime mbi sistematizimin, edhe pse kemi kërkuar edhe kontratat mbi marrjen dhe kemi theksuar që për periudhën para themelimit të Ministrisë, të dhënat duhet të dorëzohen për periudhën e Administratës së të Rinjve dhe Sportin. Me këtë, ka arsye supozimi se Ministria nuk është përgjigjur plotësisht në kërkesën, për çka IA do të kërkojë kontrollim të veprimtarisë së kancelarisë.

VLERËSIMI DHE VERIFIKIMI I AFTËSIVE: PËRVOJA E KEQE REFLEKTIM I VAKUMEVE JURIDIKE

Mbi bazat e 56 kopjeve të ankesave në vendimet e përzgjedhjes, të cilat Instituti Alternativa i ka analizuar⁷¹, gjysma, përkatësisht 27 ankesa kanë të bëjnë me lëshimet në vlerësimin e aftësive, cilësive profesionale dhe të punës së kandidatëve që imponon rëndësinë e mbikëqyrjes së procedurës së punësimit, e cila ndonëse është vendimtare, për momentin nuk është mjaftueshëm e rregulluar. Këtë e dëshmojnë ankesat e aprovuara të kandidatëve.

Komisioni për parashtrësia ka marrë vendime të ndryshme mbi rastet e ngjashme: ndërkaq rreth dy ankesave ka marrë vendim se kriteret tashmë të vlerësuar gjatë verifikimit të aftësisë, nuk mund të jetë thelb për "diskrecion" të përzgjedhjes së me vlerësim të dobët të kandidatit, në një ankesë është vendosur ndryshe.

Fjala vjen, në 4 rastet e analizuara, Komisioni i Vlerësimit të Aftësive nuk i ka vlerësuar pjesërisht përgjigjet e sakta, ndërsa

në dy raste ka konstatuar se komisioni padrejtësisht ka bërë vlerësimin. Po ashtu, në vendimet lidhur me 4 ankesat është konstatuar se kandidatët e përzgjedhur nuk i kanë plotësuar kushtet e shpalljes, që do të thotë se as që kanë mundur t'i nënshtrohen vlerësimit të aftësive, edhe pse janë përzgjedhur në vend të punës. Po ashtu, në një rast

⁷¹ / Ankesat janë marrë në bazë të kërkesave për qasje të lirë në informacion. Megjithatë, edhe pse Instituti Alternativa ka paguar shpenzimet e procedurës, emrat e institucioneve me të cilat lidhen ankesat janë fshirë pa shpjegime.

të analizuar, kandidatja nuk është ftuar në intervistë ndonëse ka realizuar përqindje të kënaqshme gjatë shënimit të vlerësimit të aftësive. Në dy raste, Komisioni për parashtresa ka aprovuar ankesën për faktin se arsyet për përzgjedhjen e kandidatit që nuk kanë qenë të renditur të parë gjatë vlerësimit të aftësive, nuk kanë qenë mjaftueshëm bindës. Në të vërtetë, si arsye vendimtare për zgjedhjen e kandidatëve janë dhënë motivacionet dhe aftësitë e komunikimit, përkatësisht deklaratat logjike dhe bindëse, që për Komisionin e shtresave nuk kanë qenë të pranueshme sepse vlerësimi i këtyre kritereve ndër të tjera, lista ka qenë e formuar.

Por, vërehet një mospërputhje e vendimmarrjes të Komisionit për parashtresa krahasuar me arsyetimet e ankesave të ngjashme. Por, në shembullin e dy rasteve Komisioni ka përcaktuar se shkak për përzgjedhjen e kandidatëve të cilët nuk janë vlerësuar më të mirët gjatë vlerësimit të aftësive, nuk duhet të jenë kualitet, të cilët janë temë të vlerësimit të njëjtë, në një rast Komisioni nuk ka marrë vendim unik. Me fjalë të tjera, në raport me një ankesë, qëndrimi ka qenë se përzgjedhja është e arsyeshme të kandidatit të rangut të dytë, sepse nëpërmjet përgjigjeve të qarta dhe të hollësishme, janë treguar përshtypjet më prezantimin personal edhe është treguar shkallë e lartë motivacioni. Këto kritere janë bazë për intervistimin me gojë, që është pjesë përbërëse e konfirmimit të aftësive.⁷² Është interesante sepse fjala është lidhur me vendin e punës epror i lartë shpërndarës-shofer, për çfarë arsytimi i vendimit edhe më shumë vihet në pyetje.

Edhe Komisioni Evropian në raportin e fundit mbi Malin e Zi, ka theksuar se vakumet në procedurat e vlerësimeve të aftësive lënë hapësira për vendim arbitrar në të gjitha nivelet, që zbeh vendosjen e sistemit të meritave në administratën publike.⁷³ Instituti Alternativa, më herët, po ashtu ka apostrofuar vakumet juridike në themelimin e komisionit për

“Ligji mbi nëpunësit dhe funksionarët shtetërorë rregullon shërbimin publik. Edhe pse ligji vendos punësimin dhe avancimin mbi bazat e rezultateve si princip, vakumet në procesin e organizimit dhe përzgjedhjes, bënë të mundur përzgjedhjen në të gjitha nivelet”. - Komisioni Evropian, raporti mbi Malin e Zi, nëntor 2016.

vlerësimin e aftësive, veçmas në drejtim të përzgjedhjes së ekspertëve të pavarur, të cilët, krahas përfaqësuesit të Drejtorisë për Kuadro dhe të organit shtetëror në të cilët bëhet punësimi e përbëjnë Komisionin për vlerësimin e aftësive. Në fakt, as në Ligj as në aktet nënligjore nuk janë përshkruar kushtet e përafërta të cilat specialistët duhet t'i plotësojnë.

Ekspertët përzgjidhen mbi bazat e shpalljes publike, të cilën e publikon Drejtoria për kuadro, që përcaktojnë kushtet e arsimit të lartë edhe, së paku, pesë vite përvojë pune në fushën e shkencave natyrore, tekniko-teknologjike, bujqësore, shoqërore e humaniste, për çka nuk ekzistojnë mekanizma që

⁷² / Dekreti për mënyrën obligimin e verifikimit të aftësive, kritereve të përafërta dhe mënyrës së vlerësimit të kandidatëve për ushtrimin e vendit të punës në organin shtetëror (“Gazeta zyrtare e Malit të Zi”, nr. 004/13, 027/16 nga 25.04.2016)

⁷³ / Komisioni Evropian, Raporti mbi Malin e Zi, nëntor 2016.

të sigurohet përputhshmëri të ekspertizës së ekspertëve dhe të përshkrimit të punëve të vendit të punës që plotësohet. Po ashtu ata nuk përzgjidhen mbi bazat e vendimeve të veçanta, por në mënyrë diskrecioni nga ana e Drejtorisë për Kuadro. Gjatë vitit 2016, 35 ekspertë të profileve të ndryshme kanë marrë pjesë në komisionet e vlerësimit të aftësive. Është e dukshme se një numër specialistësh punon tashmë në administratën shtetërore, që do të mund të ndikojë negativisht në paanshmërinë e tyre me rastin e vlerësimit të aftësive.⁷⁴

NIVELI LOKAL: PASIGURIA JURIDIKE PËR ARSYE TË INTERPRETIMIT KREATIV “SIPAS ZBATIMIT”

Të dhënat të cilat i kemi grumbulluar nga 4 qeverisje lokale, konfirmojnë problemet në pamundësinë karshi zbatimit të dispozitave, të cilat rregullojnë sistemin e nëpunësisë në nivelin shtetëror.

Ekzistojnë probleme të shumta në praktikë kur bëhet fjalë për themelimin e komisionit mbi verifikimin e aftësive.⁷⁵ Kryeqyteti ka refuzuar të ofrojë pasqyrën e emrave dhe mbiemrave të nëpunësve në vendet e punës, si dhe emrat dhe mbiemrat e kandidatëve nga lista e përzgjedhjes (rang lista) edhe nuk mund të jetë arsye e mbrojtjes së emrave personalë, duke marrë parasysh se publikimi i listave të të punësuarve është edhe detyrim, i

Kryeqyteti nuk mund të lavdërohet me transparencën e punësimit: Institutit Alternativa nuk i është lejuar kontrollimi i emrave dhe mbiemrave të përzgjedhjes së nëpunësve dhe funksionarëve lokalë.

përcaktuar me Ligjin mbi Qasjen e Lirë në Informata.⁷⁶

Gjatë vitit 2016, në Kollashin janë marrë aktvendime mbi përzgjedhjen e katër nëpunësve. Në dy raste janë përzgjedhur kandidatët të cilët kanë qenë të vetmit që

kanë kënaqur apo kaluar verifikimin e aftësive. Në dy rastet tjera nuk ka pasur verifikim të aftësive, me arsyetimin se me kontrollimin e fletëparaqitjes së të punësuarit dhe në dosje të lëndës, është konstatuar se kandidati i paraqitur në kohën e duhur i plotëson të gjitha kushtet e shpalljes publike edhe nuk ka pengesa që ai të pranohet në vendin e lirë të punës.⁷⁷ Në këto raste, Administrata e Inspektimit më pas ka zbuluar parregullsi.⁷⁸

74 / Në përgjigjen e kërkesës për qasje të lirë në informata, të cilën Instituti Alternativa ia ka dërguar Ministrisë për Kuadro, (vendimi nr.07 UPI-007/17-368/3), janë deponuar vetëm aktvendimet e themelimit dhe përbërjen e komisionit për verifikimin e aftësive, por mungon vendimi mbi përzgjedhjen e kandidatit. Kjo praktikë krijon mundësitë e ndikimit ad hoc rreth themelimit të komisioneve, puna e së cilëve ka një rol të madh në procedurat e punësimit.

75 / Në intervistat me përfaqësuesit e administratave lokale të Kollashinit dhe Plevles, është theksuar se gjetjet e problemeve në themelimin e komisioneve të aftësive, veçmas në aspektin e verifikimit të përzgjedhjes së specialistëve të pavarur që do të merrnin pjesë në to.

76 / Për shkak të mjegullinave të emrave dhe mbiemrave, IA i ka deponuar ankesë Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Qasje të Lirë Informacioneve.

77 / Përgjigja në kërkesën për qasje të lirë në informacione

78 / Intervistë me Zhelko Vuksanoviçin, kryetar i Komunës Kollashin dhe Perunik Popoviçin, kryeadministrator i Komunës Kollashin, më 10 maj 2017 në zyrat e Komunës Kollashin.

Në Komunën e Plevles janë marrë dy aktvendime lidhur me zgjedhjet: në njërin rast kandidatët e përzgjedhur ka qenë i vetmi, ndërsa në rastin e dytë janë përzgjedhur të renditurit e parë nga lista e 5 kandidatëve. Në Komunën e Ulqinit janë marrë 15

Administrata e prokurimeve publike ka refuzuar parimin e qasjes së vlerësimit të punësuarve, edhe pse IA ka kërkuar edhe emrat dhe mbiemrat e fshirë. Në Agjencinë për mbrojtjen e mjedisit, të gjithë të punësuarit gjatë vitit 2016 kanë qenë të shkëlqyeshëm.

aktvendime mbi përzgjedhjen edhe të gjithë aktvendimet janë realizuar sipas radhës së kandidatëve nga lista për të përzgjedhurit (renditja).

Ankesat në aktvendimet mbi përzgjedhjen në nivelin lokal tregojnë shtesë e lëshimeve në organizimin e verifikimit të aftësive. Ndër të tjera, ankesa e kandidatit për punë në njërin prej shërbimeve të

Kryeqytetit është aprovuar sepse pjesën praktike të verifikimit nuk është zbatuar fare. Në Plevle ankesa është miratuar sepse është shpallur vend i plotësuar i vendit të punës. Po ashtu në disa raste, është e dukshme se kandidatët nuk kanë ditur se cili është organi kompetent për ankesa lidhur me aktvendimin të përzgjedhjes së nëpunësve tjerë, por ankesat e tyre janë transferuar nga ana e Sekretariatit të Komisionit për Parashtresa.

VLERËSIMI: LARG NGA VLERËSIMI I NDIKIMIT

Edhe në nivelin lokal, edhe në nivelin shtetëror, vlerësimi i punës së nëpunësve bëhet më shumë për të plotësuar normën se sa për tu realizuar vlerësimi thelbësor i të punësuarve. Vlerësimet e punës, rrallëherë sillen në afat, i cili është deri më 31 janar të vitit për atë pararendës, dhe se arsytimi i tyre është përshkrimi i dispozitave ligjore pa analiza të hollësishme të rezultateve të punës edhe apostrofimin e nevojës për perfeksionimin e mëtejshëm profesional.

Kësisoj, **Drejtoria e Pronës** ka vlerësuar vetëm 15 nëpunës më 3 mars 2017, 9 kanë marrë notë të shkëlqyeshme, ndërsa 6 të kënaqshme. Mbi bazat e kontrollit në 2795 aktvendimeve mbi vlerësimin e punës në Ministrinë e Punëve të Brendshme shumica e nëpunësve kanë marrë notën e punës **mirë** (2.013). Nga nëpunësit tjerë, 451 janë notuar me notën **të shkëlqyer**, vlerësimin kënaqur 330, kurse një nëpunës i MPB, ka marrë notën “nuk kënaq”. Gjithsej, pesë për qind e vendimeve të MPB, në të cilat IA ka realizuar kontrollin, janë sjellë në afatin ligjor.

Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit e ka përfillur afatin ligjor, edhe të gjitha vendimet i ka sjellë më 31 janar 2017, edhe të gjithë janë të shkëlqyeshëm. **Sekretariati për Projektet Zhvillimore**, ngjashëm me Agjencinë ka përfillur afatin ligjor. Shumica e nëpunësve (8 sish) janë vlerësuar të shkëlqyeshëm, ndërsa dy nëpunës kanë marrë vlerësimin mirë. **Administrata e Prokurimeve Publike** ka refuzuar qasjen e vlerësimit për shkak të mbrojtjes

së të dhënave personale, që nuk ka arsye të refuzimit, por të dorëzimit të informacionit në vëllim të kufizuar, krahas fshirjes së emrave dhe mbiemrave.

Mbrojtësi i Interesave Pronësore-Juridike nuk zbaton vlerësimin, derisa Ministria e Financave, gjykuar sipas vlerësimeve të nëpunësve, është regjistruar në institucionet e suksesshme. Nga gjithsej, 238 nëpunës – 220 nëpunës kanë marrë notë “shkëlqyeshëm”, 9 nëpunës «m i r ë» dhe 9 drejtorë të përgjithshëm «kënaqshëm», krahas vërejtjes se kuadri i lartë udhëheqës, ku radhiten edhe drejtorët e përgjithshëm, vlerësohen vetëm me notat kënaqshëm edhe nuk kënaqin.

Është interesant fakti se kur bëhet fjalë për qeverisjet lokale, shpjegimet e vlerësimeve janë më të plota dhe përmbajnë notat për çdo kriter individual (rezultatet e arritura të punës, pavarësinë dhe kreativitetin në kryerjen e punëve, cilësinë e bashkëpunimit me palë dhe bashkëpunëtorët në punë, cilësinë e organizimit të punës për kryerjen e detyrave, aftësi të tjera, shkathtësitë dhe cilësinë e kryerjes së punës) dhe çdo treguesi në kuadër të kriterëve, në përputhje me Rregulloren mbi Kriteret dhe Mënyrën e Vlerësimit të Zyrtarëve dhe Nëpunësve Civilë, si dhe notën mesatare.

Podgorica gjatë vitit 2016 ka nxjerrë 327 vendime mbi vlerësimet, brenda afatit ligjorë. 219 zyrtarë ishin vlerësuar me notën shkëlqyeshëm, 95 me notën mirë dhe 13 me notën kënaqshëm. Në Ulqin, gjatë së njëjtës periudhë janë nxjerrë 35 vendime, nga të cilat 24 brenda afatit ligjorë dhe 11 pas afatit. Më notë shkëlqyeshëm u vlerësuan 22 zyrtarë, me notën mirë 9 dhe me notën kënaqshëm 4. Në komunën e Kollashinit u vlerësuan me notën “nuk kënaq” 5 zyrtarë, 29 me notën “mirë”, 10 kënaqshëm, ndërsa gjatë vitit 2016 ka pasur 7 të shkëlqyeshëm. Komuna e Plevles ka refuzuar qasjen në vlerësime.

ÇFARË MË TEJ?

Fillimi i zbatimit të Strategjisë së Reformës në Administratës Publike as sot e kësaj dite nuk i ka dhënë hov kësaj reforme të rëndësishme. Me realizimin e disa aktiviteteve vonohet, ndërsa përmbushja formale të masave të caktuara mund të rezultojnë me efekte negative në praktikë, që më së miri ilustron shembulli i ndryshimeve të Ligjit mbi Qasjen e Lirë në Informata.

Në parim, zhvillimi dhe koordinimi i politikave publike, punësimi në nivelin lokal dhe verifikimi i aftësive të kandidatëve për punë në organet shtetërore, janë aspektet më problematike të reformës. Ndryshimet e Ligjit mbi Qasjen e Lirë në Informata po ashtu do të mund të ngecin transparencën, me këtë edhe përgjegjësinë e administratës, sepse inkorporojnë organizime shtesë për qasje e informacioneve.

Kapacitetet e Inspektimit të Administratës, e cila do të duhej të jetë garantuese e mbikëqyrjes efektive mbi veprimet administrative, në fillim të vitit 2017, kanë qenë në nivelin më të ulët në vitet e fundit-me katër inspektorë administrativë. Në anën tjetër, gabimet që bëjnë organet e administratës, shtrojnë nevojën e mbikëqyrjes administrative dhe të inspektimit: kontrolli i lëndëve të cilat kanë qenë në punë te Ombudsmani gjatë vitit 2016, dëshmojnë mospërfilljen elementare të Ligjit të Administratës Publike, njësoj si veprimi krahas shkeljes së ligjit, i cili paraqet problem dhe mospërfilljen e organit në rastet konkrete, po ashtu, ka arsye të akuzave të qytetarëve.

Problemet e njëjës fushë të administratës publike transferohen në sistemet tjera të "gjyqeve të bashkuara". Mënyra në të cilën Administrata e Inspektimit nuk ka pasur mundësi që të bëjë kontrollimin e veprimtarisë së kancelarisë në iniciativën e Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Qasje të Lirë në Informacione, edhe të aprovuara me pas mbi 190m denoncime për heshtje të Administratës kundër Agjencisë nga ana e Gjyqit Administrativ, tregon përmasat e problemeve, të cilët nuk mund të zgjidhen me hapa të izoluar në disa fusha të reformës së Administratës Publike.

REKOMANDIME

PËR FUSHËN E PËRGJEGJSHMËRISË⁷⁹:

- Në Ligjin mbi Qasjen e Lirë në Informata duhet fshi kufizimet për qasje informacioneve, nëse kemi të bëjmë me fshehtësinë “afariste” ose “tatimore”;
- Në Ligjin mbi Qasjen e Lirë në Informata duhet fshi dëshminë e interesit të posaçëm si bazë të deponimit të kërkesës për shfrytëzimin e serishëm të informacioneve;
- Procesverbalet mbi kontrollin e inspektimit të administratës duhet përsëri të publikohet në faqen e **Ministritë së Administratës Publike**;
- Raportimi i **Ombudsmanit** duhet të jetë i strukturuar në atë mënyrë që të tregohen informacionet dhe burimet e informacioneve, krahas apostrofimit të segmenteve në të cilat rekomandimi është plotësuar;
- **Ombudsmani** duhet të publikojë të gjitha mendimet me rastin e veprimit të organit të administratës edhe në rastin kur nuk janë konstatuar cenime të të drejtave dhe lirive të njeriut në mënyrë që të krijohen kushtet për një përfshirje të gjithmbarshme të veprimit të administratës nëpërmjet prizës së punës së këtij institucioni;
- **Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Qasjes së Lirë në Informacione** në planin pasues të mbikëqyrjes së informacioneve të publikuara pro aktive me rëndësi publike në internet, duhet të kyçen të gjitha vetëqeverisjet lokale;

PËR FUSHËN E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE:

- **Ministritë, organet e administratës shtetërore dhe vetëqeverisjet lokale** duhet të hartojnë katalog të shërbimeve që ofrojnë për të avancuar informimin e qytetarëve edhe politikat e mëtejme në modernizimin e shërbimeve do të mund të zbatohen krahasuar me gjendjen fillestare;
- **Ministria e Administratës Publike** duhet të sigurojë parakushte teknike, duke përfshirë edhe certifikatën digjitale për të vendosur shërbimet e vetëqeverisjeve lokale në portalin e-administratës;
- **Grupi i ndërsektorial**, i përbërë nga përfaqësuesit e Ministritë së Administratës Publike, ministritë me numrin më të madh të kontesteve administrative (siç është Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale), Bashkësia e Komunave dhe të Gjykatës Administrative, duhet të jenë të themeluara me qëllim të zbatimit të Ligjit mbi Veprimin Administrativ dhe këmbimin e mendimeve me qëllim të avancimit të implementimit;

⁷⁹ / Rekomandime specifike për këtë fushë jepen edhe në letrën e Institutit të Financave Publike Alternative dhe përgjegjësisë së menaxhmentit: Çfarë mbron Mbrojtësi?, nëntor 2016, në dispozicion: <http://media.institut-alternativa.org/2016/12/Zastitnik-Javne-Financë-Online.pdf>

PËR FUSHËN E ZHVILLIMIT DHE KOORDINIMIT TË POLITIKAVE PUBLIKE:

- **Raportimi nga shqyrtimet publike** duhet të tregojë strukturën e pjesëmarrësve individualisht, duke shënuar emrat dhe mbiemrat në fushat për të cilat pjesëmarrësit kanë dhënë komente;
- **Raporti nga shqyrtimet publike** duhet të përmbajë arsyetimet për çdo koment të marrë gjatë diskutimit publik me arsyetimet pse pranohet ose refuzohet koment;

PËR FUSHËN E SISTEMIT TË NËPUNËSISË DHE DREJTIMIT ME RESURSET NJERËZORE:

- Me qëllimin e arsytimit të integritetit të procedurës së verifikimit të aftësive të kandidatit për punë në administratën publike, të **akteve nënligjore** duhet ndryshuar mënyra që precizon kushtet dhe kriteret për angazhimin e ekspertëve të pavarur në komisione të verifikimit të aftësive, për çka duhet pasur parasysh se ata nuk janë të punësuar në administratën publike dhe se mjaftueshëm janë specialistë për punë të kërkuara me shpalljen konkurs;
- **E drejta e diskrecionit**, që të mos përzgjidhet kandidati i renditur i pari për punë në organet e administratës, duhet kufizuar në situata të caktuara në kriteret objektive, siç është gjendja ku disa kandidatë kanë arritur numër të ngjashëm të pikëve, ose për arsye të përfilljes së parimeve të diskriminimit pozitiv;
- **Vlerësimi** i punës së nëpunësit duhet të bëhet në krahasim me qëllimet e vendosura të mëparshme dhe indikatorët e suksesit, në mënyrë realizimit të rolit të vlerësimeve të arritjeve të të punësuarve dhe planifikimit të zhvillimit të tyre profesional.

BURIMET:

- Analiza mbi llojin dhe mostrat e kontesteve, pozitën juridike, përcaktimin e kuadrove dhe të pajisjeve teknike të Mbrojtësit të Interesave Pronësore-Juridike me propozimin e Avancimit të pozitës së Mbrojtësit në të mirë të mbrojtjes së pronës shtetërore, Qeveria e Malit të Zi, Podgoricë, 7 shkurt 2017 .
- Analiza e veprimit të institutit të ri LPA dhe LKA në zbatimin dhe veprimin e Gjykatës Administrative të Malit të Zi, Gjykata Administrative e Malit të Zi, UNDP, Podgoricë, dhjetor 2015
- Çmimorja për lëshimin dhe përtëritjen e certifikatës së kualifikimit digjital, Posta e Malit të Zi
- Direktiva 2013/37/UE të Parlamentit dhe Këshillit Evropian, më 26 qershor 2013 mbi ndryshimet e Direktivës 2003/98/BE mbi përdorimin e serishëm të informacioneve të sektorit publik, Gazeta zyrtare e Bashkimit Evropian, L 175/1, të disponueshme në:
<http://eur-lex.europa.eu/legal-content/HR/TXT/PDF/?uri=CELEX:32013L0037&from=EN>

- Komisioni Evropian, raporti mbi Malin e Zi, nëntor 2016
- Qytetarët në sportel: Eksperiencia e vizituesve sekretë, IPSOS agjencia për nevojat e Institutit Alternativa, mars 2017
- Informata mbi përmbushjen e kushteve për fillimin e zbatimit të Ligjit mbi Veprimtarinë Administrative, Podgoricë, mars 2017, të disponueshme në: http://www.gov.me/sjednice_vlade_2016/20
- Informata mbi portalin e-administratës për vitin 2016, Qeveria e Malit të Zi, Ministria e Administratës Publike, mars 2017
- Ndryshimet e Ligjit mbi Mbrojtjen Sociale dhe të Fëmijëve: Përjashtimi i opinionit për, gjoja, të veprimit urgjent, Institutit Alternativa, më 06.06.2017 të disponueshme në: <http://institut-alternativa.org/izmjene-zakona-o-socijalnoj-i-djecjoj-zastiti-iskljucivanje-javnosti-pod-izgovorom-hitnog-postupka/>
- Raporti i Ministrisë së Punëve të Brendshme mbi punën dhe gjendjen në fushat e administratës për vitin 2015, prill 2016
- Raporti nga shqyrtimi publik mbi Propozim Ligjin e Rregullimit Hapësinor dhe Ndërtimin e Objekteve, Ministria e Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe Turizmit, më 26.09.2016, f. 126, të disponueshme në : http://www.mrt.gov.me/rubrike/javna_rasprava/165311/Izvjestaj-o-javnoj-raspravi-o-Nacrtu-zakona-o-uredenju-prostora-i-izgradnji-objekata.html
- Raport nga shqyrtimin publik mbi Draft ligjin e pagave të punësuar në sektorin publik, i disponueshëm në: http://www.gov.me/sjednice_vlade/134
- Informata mbi zbatimin e Ligjit të Pagave të Punësuar në sektorin publik, Qeveria e Malit të Zi, seanca e 167, pika 4, të disponueshme në: http://www.gov.me/sjednice_vlade/167
- Raport mbi realizmin e Planit të aksionit për zbatim të Strategjisë së Reformës së Administratës në Malin e Zi 2016-2020 në vitin 2016, Qeveria e Malit të Zi, Podgoricë, mars 2017.
- Raporti mbi gjendjen e mbrojtjes së të dhënave personale në fushën e qasjes së informacioneve për vitin 2016, Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Qasjes së Lirë, Podgoricë, mars 2017, i disponueshëm në: <http://www.azlp.me/me/izvjestaji>
- Raporti mbi gjendjen e mbrojtjes së të dhënave personale dhe gjendja në fushën e qasjes së lirë informacioneve për vitin 2015, Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Qasjes së Lirë në Informata, Podgoricë, mars 2016, është në dispozitim: <http://www.azlp.me/me/izvjestaji>
- Jovanka Laliçiq dhe Marta Shqëpanović, Propozim për ndryshimin e Ligjit mbi procedurën administrative, 31 maj, 2017. <http://www.skupstina.me/zakoni/web/dokumenta/zakoni-i-drugi-akti/164/1441-9123-23-1-17-5.pdf>

- Milena Millosheviq, Financat Publike dhe Përgjegjësia e Administratës: Çfarë mbron Mbrotjtësi? Instituti Alternativa, nëntor 2016 është në disponim në: <http://media.institut-alternativa.org/2016/12/Zastitnik-Javne-finansije-online.pdf>
- Milena Millosheviq, Raporti monitorues: Punësimi dhe avancimi në organet shtetërore në vitin 2014, Instituti Alternativa, Podgoricë, maj 2017, i disponueshëm në: <http://institut-alternativa.org/monitoring-izvjestaj-zaposljavanje-i-napredovanje-u-drzavnim-organima-u-2014-godini/>
- Mendimi i Ministrisë së Financave në Propozim ligjin mbi plotësimin e pagave të të punësuarve në sektorin publik, f. 20 është në disponim në: <http://www.skupstina.me/zakoni/web/dokumenta/zakoni-i-drugi-akti/70/1345-8483-33-16-8.pdf>
- Draft ligji mbi rregullimin hapësinor dhe ndërtimtari të objekteve është në disponim në: http://www.mrt.gov.me/rubrike/javna_rasprava/154804/Nacrt-zakona-o-uredenju-prostora-i-izgradnji-objekata.html
- Perceptimi i Administratës Publike: Hulumtimi i opinionit publik, Agjencia për Nevojat e Institutit Alternativa, IPSOS, shkurt 2017
- Rebalanci i buxhetit – çfarë ka ndodhur në të vërtetë edhe kush është përgjegjës? Instituti Alternativa, është në disponim: <http://institut-alternativa.org/rebalans-budzeta-sta-se-zapravo-desilo-i-ko-je-odgovoran/>
- Vendimi mbi themelimin e grupit mes resor mbi përgatitjen e Propozim ligjit të ndryshimeve dhe plotësimeve të Ligjit mbi Nëpunësit dhe Funkionarët, Qeveria e Malit të Zi, Ministria e Punëve të Brendshme, vendimi nr.1-050/15-50350/1, Podgoricë, më 28.7.2015
- Strategjia e Reformës së Administratës Publike në Malin e Zi për periudhën 2011-2016. "AURUM", Qeveria e Malit të Zi, Podgoricë, mars 2011
- Strategjia e Reformës së Administratës Publike në Malin e Zi, 2016-2020, Qeveria e Malit të Zi, korrik 2016, e disponueshme në: <http://media.mojauprava.me/2016/11/Strategjia-reforme-javne-uprave-u-Crnoj-Gori-2016-2020.godine.pdf>
- Fshehurazi mbi prokurimet publike: Ndryshimet kontestuese ngecin sistemin, Instituti Alternativa, më 23.05.2017, në disponim: <http://institut-alternativa.org/tajno-o-javnim-nabavkama-sporne-izmjene-unazaduju-sistem/>
- Dekreti mbi organizimin dhe mënyrën e punës në administratën shtetërore, Gazeta zyrtare e Malit të Zi, nr. 005/12, 025/12, 044/12, 061/12, 020/13, 017/14, 006/15, 080/15, 035/16, 041/16, 061/16, 073/16, 003/17, 019/17

- Dekreti mbi mënyrën verifikimit të obligueshëm të aftësive, kriteret e përfaqëta dhe mënyrën e vlerësimit të kandidatëve për ushtrimin e punëve në organet shtetërore, "Gazeta zyrtare e Malit të Zi" nr. 004/13, 027/16
- Qeveria e Malit të Zi, nr. 07-883, Podgoricë, më 13 prill 2017, në disponim: http://www.gov.me/sjednice_vlade_2016/20
- Ligji mbi Identifikimin Elektronik dhe Nënshkrimin Elektronik, "Gazeta zyrtare e Malit të Zi", nr. 031/17
- Ligji mbi Administratën Elektronike, "Gazeta zyrtare e Malit të Zi", nr. 32/2014
- Ligji mbi Qasjen e Lirë në Informata, "Gazeta zyrtare e Malit të Zi", nr. 044/12, 030/17
- Ligji mbi Administratën e Inspektimit, "Gazeta zyrtare e Malit të Zi", nr. 042/16
- Ligji mbi Qasjen Administrative, "Gazeta zyrtare e Malit të Zi", nr. 056/14, 020/15, 040/16, 037/17

INTERVISTAT:

- Intervistë me Branko Llakoçeviq, kryetar i Gjykatës Administrative, realizuar më 3 maj 2017 në zyrat e Gjykatës administrative
- Intervistë me Zhelko Vuksanoviçin, kryetar i komunës Kollashin dhe Perunik Popoviç, kryeadministrator i komunës së Kollashinit, realizuar më 10 maj 2017 në zyrat e komunës Kollashin
- Intervistë me përfaqësuesin e Shërbimit të Kuadrove dhe kryetaren e Komisionit Parashtresa në komunën e Plevles, realizuar më 16 maj 2017 në zyrat e komunës së Plevles
- Intervistë me Ahmet Aloshin, ish- sekretar i administratës dhe anëtar i Komisionit për Verifikimin e Aftësive, dhe Burim Kromën, kryetar i Komisionit për Parashtresa, realizuar më 22 dhe më 25 maj
- Intervistë me Çedomir Mitroviçin, drejtor i Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Qasjes së Lirë në Informata, (AZLP), Muhamet Gjokaj, kryetar i Këshillit AZLP, Bilana Bozhiq, udhëheqëse e sektorit për qasje në informata në AZLP, dhe Nenad Durkoviç, udhëheqësin e sektorit të Regjistrimit dhe sistemin informativ, realizuar më 12 maj 2017 në zyrat e Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Qasjes së Lirë në Informata
- Intervistë me Milica Jankoviç, U.D. së drejtorit të përgjithshëm, Drejtorisë për Administratë Elektronike dhe Siguri Informative të Ministrisë së Administratës Publike, realizuar më 9 qershor 2017 në zyrat e Ministrisë së Administratës Publike
- Intervistë me Daniela Nedelkoviç Vukçeviq, U.D. së drejtoreshës së përgjithshme të Drejtorisë për Administratë Publike, realizuar më 5 maj 2017, në zyrat e Ministrisë së Punëve të Brendshme.
- Intervistë me Petar Ivezic, zëvendës i Ombudsmanit për sektorin e administratës shtetërore, Jovana Duroviçin, shefe e shërbimit të Ombudsmanit dhe Marina Perishqi, këshilltare kryesore për procedurë komfor denoncimeve, realizuar më 25 prill 2017 në zyrat e Mbrojtësit të së Drejtave të Njeriut dhe të Drejtave të Pakicave.

FOKUS GRUPET:

- Fokus grupet me përfaqësuesit e organizatave joqeveritare, Rrjeti për Afirmimin e Sektorit Joqeveritar (RAJQ), Qendrën e Arsimit Qytetar (QAQ), Qendrën për Tranzicion Demokratik (QTD), Shoqata e të Rinjve Handikap të Malit të Zi (SHRHMZ) dhe Qendra për Zhvillimin e Organizatave Joqeveritare, realizuar më 10 maj në zyrat e Institutit Alternativa.

SHTOJCA 1. LËNDËT E PËRFUNDUARA NË GJYKATËN ADMINISTRATIVE GJATË VITIT 2016 NËPËR MINISTRI DHE PËRFUNDIMI⁸⁰.

Ministritë	Numri i lëndëve të përfunduara	Numri i vendimeve që kanë anuluar vendimet e ministrive
Ministria e Punës dhe Asistencës Sociale	1.116	830
Ministria e Financave	836	343
Ministria e Punëve të Brendshme	101	38
Ministria e Ekonomisë	18	13
Ministria e Shëndetësisë	24	19
Ministria e Mbrojtjes	7	4
Ministria e Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe Turizmit	23	11
Ministria e Drejtësisë	10	6
Ministria e Komunikacionit dhe Detarisë	7	4
Ministria e Arsimit	4	3
Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	27	13

SHTOJCA 2: ORARI I VIZITAVE NËPËR KOMUNA MBËSHTETUR NË SKENARËT SPECIFIKE NË KUADËR TË HULUMTIMEVE ME METODËN “VIZITUESI SEKRET”

Komuna	Skenari			
	Regjistrimi i prodhuesve bujqësorë	Lëshimi i letërnjoftimeve	Kurorëzimi	Lëshimi i lejes së ndërtimit
Tivar	Ministria e Bujqësisë	Njësia rajonale e MPB	Sekretariati për Veprimtari të Përgjithshme dhe Veprimtari Shoqërore	Sekretariati për Rregullim Hapësinor, Veprimtari Komonale – Banesore, dhe Mbrojtjen e Mjedisit
Bijello Pole	Ministria e Bujqësisë	Njësia rajonale e MPB	Sekretariati për Qeverisje Lokale	Sekretariati për Rregullim Hapësinor dhe Zhvillim të Qëndrueshëm
Danilovgrad	Sekretariati për Financa dhe Zhvillim Ekonomik	Njësia rajonale e MPB Podgoricë-filiali Danilovgrad	Sekretariati për Administratë dhe Veprimtari Shoqërore	Sekretariati për Urbanizëm, Veprimtari Komonale, Çështje Banesore, Komunikacion dhe Mbrojtje të Mjedisit
Kollashin	Sekretariati për Ekonomi dhe Financa	Njësia rajonale e MPB	Sekretariati për Administratë, Veprimtari Shoqërore dhe shërbime të përbashkëta	Sekretariati për Planifikim dhe Rregullim Hapësinor, Çështje Komonale, Banesore dhe Mbrojtjen e Mjedisit
Nikshiq	Ministria e Bujqësisë	Njësia rajonale e MPB	Sekretariati për Qeverisje Lokale	Sekretariati për Urbanizëm (Rregullim Hapësinor dhe Mbrojtje të Mjedisit)
Plevla	Ministria e Bujqësisë	Njësia rajonale e MPB	Sekretariati për Administratë të Përgjithshme	Sekretariati për Rregullimin Hapësinor
Podgoricë	Ministria e Bujqësisë	Njësia rajonale e MPB	Sekretariati për Qeverisje Lokale	Sekretariati për Planifikim dhe Rregullim Hapësinor dhe Mbrojtje të Mjedisit
Ulqin	Sekretariati për Ekonomi dhe Zhvillim Ekonomik	Njësia rajonale e MPB Tivar, filiali Ulqin	Sekretariati për Administratë dhe Veprimtari Shoqërore	Sekretariati për Planifikim Hapësinor dhe Zhvillim të Qëndrueshëm

PËR INSTITUTIN ALTERANTIVA

Ky institut vepron si Think Tank, përkatësisht si një qendër kërkimore dhe merret me fushat e një qeverisje të mirë ku hynë transparenca dhe llogaridhënia. Fushat në të cilat atë punojnë dhe veprojnë janë të strukturuar brenda këtyre programeve: administrimi publik, financat e përgjegjshme publike, programin parlamentar, siguri dhe mbrojtje. Në kuadër të programit të tyre merren edhe me monitorimin e procesit të negociatave për anëtarësimin në BE, me pjesëmarrjen aktive në grupet e punës për negocimin e kapitujve 23 dhe 32. Aktiviteti i tyre i veçantë është Shkolla e Politikave Publike që e organizojnë që nga vitin 2012. Në vitin 2013, IA është licencuar nga Ministria e Shkencës, si një institut për kërkime shkencore.

Projekti 'SHOQËRIA CIVILE PËR NJË QEVERISJE MË TË MIRË: i financuar nga Bashkimi Evropian në kuadër të programit për mbrojtjen dhe zhvillimin e organizatave të shoqërisë civile, i implementuar nga Instituti Alternativa, Bonum, Natura, Horizonti i Ri dhe Qendra për Gazetari Hulumtuese. Qëllimi i këtij projekti është përmirësimi i praktikës së qeverisjes së mirë në Mal të Zi.

MOJA UPRAVA

WWW.MOJAUPRAVA.ME